

Mbi Organizimin Politik (në fazën e Ristrukturimit)

“Politika është raport midis revolucionit dhe institucionit.” – Ukshin Hoti

“Më i vogli bëhet ekuivalent me të madhin porsa të mos jetë i ndarë prej çfarë mund të bëjë.” (“The smallest becomes equivalent to the largest once it is not separated from what it can do”.) – Gilles Deleuze

“Triumfi i çdo gjëje është çështje e organizimit.” (“The triumph of anything is a matter of organization”.) – Kurt Vonnegut

Organizata është organizatë e Lëvizjes. Organizata është strukturë e aktivistëve dhe komunitet i njerëzve, hierarki përgjegjësish dhe bashkësi politike. Organizimi politik është mendim dhe veprim i organizuar.

Lëvizja VETËVENDOSJE! ka nevojë që nga teoria politike të kalojë te teoria organizative. Ashtu sikurse që praktikat politike dështojnë pa teorinë, ngjashëm edhe praktikat organizative s’janë të qëndrueshme pa i teoretizuar.

Ristrukturimi ynë nënkupton dy lëvizje të Lëvizjes:

I. Lëvizja brenda Lëvizjes:

- 1) Decentralizim i udhëheqjes në Prishtinë (Kryesia, Grupi Parlamentar, Sekretariati i Përgjithshëm, drejtorët e Komunës së Prishtinës) anekënd komunave të Kosovës për zgjerim dhe dinamizim të Qendrave të VETËVENDOSJE!-s;
- 2) Aktivizim konkret dhe i planifikuar i afër 20.000 anëtarëve të regjistruar që i ka VETËVENDOSJE!.

II. Lëvizja jashtë Lëvizjes:

- 1) Tryezë opozitare për opozitë të bashkuar në Kuvendin e Kosovës me AAK, Nisma, ndonjë deputet të pavarur, si dhe front shoqëror jashtë Kuvendit duke u zgjeruar me sindikata, OJQ dhe intelektualë e profesionistë të shquar;
- 2) Ndarje e detyrave për anëtarët e VETËVENDOSJE!-s aty ku ata punojnë e sipas profesionit që ushtrojnë në mënyrë që në organizata, shoqata, ndërmarrje, sindikata etj. të bëhet sa më shumë orientimi atdhetar dhe i majtë i tyre si dhe mobilizimi për veprim konkret.

I.2) dhe II.2) janë të ndërlidhura ngushtë. Duke i njohur aktivistët sipas profesionit dhe vendit të tyre të punës ne u ndajmë atyre detyra përkatëse.

Deri në vitin 2015, Kryesia e VETËVENDOSJE!-s ishte kryesi reprezentative. Ajo e ka rritur sasinë e cilësisë së aktivistëve tonë: kemi shumë figura publike tash. Në vijim, Kryesia duhet të ketë më shumë karakterin organizativ. Ajo duhet ta rrisë cilësinë e sasisë së aktivistëve: të kemi struktura të fuqishme e rrjet të gjerë. Pas ngritjes ideo-politike të më shumë aktivistëve individualisht në publik në këto vitet e fundit, tani duhet ngritur mesatarja e të gjithë aktivistëve në aftësitë dhe përgatitjen e tyre.

Ashtu sikurse lëvizjet ilegale që në kushtet e okupimit kanë qenë e pavetëdijshme e popullit, sot këtë rol e funksion e ka Lëvizja VETËVENDOSJE!.

Tërësia është pikënisje

Në organizim, tërësia duhet të jetë pikënisja e të menduarit dhe planifikuarit.

Të gjitha Qendrat e VETËVENDOSJE!-s duhet ta regjistrojnë gjendjen në komunat e tyre përkatëse, duke evidentuar strukturat institucionale, politike, shoqërore, ekonomike, arsimore, shëndetësore, kulturore, sportive, fetare etj. si dhe përbërjen e tyre. Në këto struktura bëjnë pjesë:

- Profesorët e shkollave të mesme; profesorët e shkollave fillore; drejtorët e shkollave të mesme; drejtorët e shkollave fillore; nxënësit e klasëve të XI-ta dhe XII-ta.
- Ish punëtorët e fabrikave me udhëheqjen e tyre; krerët e degëve të sindikatave.
- Drejtuesit e OJQ-ve lokale; gazetarët e komunës.
- Pronarët dhe shitësit në furrat e bukës; pronarët dhe kamarierët në kafiteritë më të frekuentuara; pronarët dhe shitësit në barnatore; pronarët dhe shitësit në shitoret e fshatrave; pronarët dhe kamarierët në çajtores; pronarët dhe shitësit në pompat e benzinës.
- Pronarët dhe shoferët e autobusëve; pronarët dhe shoferët e taksive.
- Veterantët dhe invalidët e luftës; familjet e dëshmorëve dhe martirëve; ish të burgosurit politikë.
- Berberët dhe frizeret.
- Hoxhallarët, shehët dhe priftërinjtë.
- Familjet e mëdha në komunë.
- Pjesëtarët në FSK nga komuna; pjesëtarët në polici dhe zjarrfikësit në komunë.
- Inkasantët e KEDS-it, të Ujësjellësit dhe të Mbeturinave, të Bashkësisë Islame.
- Pronarët e qendrave rekreative e të fushave të futbollit; Kryesitë, trajnerët, drejtorët dhe lojtarët e ekipeve sportive.
- Kryetarët dhe kryesitë e Bashkësive Lokale nëpër lagjet e qytetit dhe fshatrave.
- Kryesitë e degëve të partive kryesore politike, udhëheqja komunale, si dhe zyrtarët ndërkombëtarë në komunë.
- Motrat medicinale, mjekët dhe drejtorët e Qendrave të Mjekësisë Familjare.
- Udhëheqësit dhe të punësuarit në Qendrat për Asistencë Sociale.
- Njerëzit e shquar të komunës që jetojnë e veprojnë në Prishtinë.

Për çdo qytetar në përgjithësi janë tri elemente themelore të identifikimit: vendbanimi, shtesa shoqërore, profesioni/veprimtaria. Dhe, dy të tjera shtesë: mosha dhe gjinia.

Të gjithë këtyre njerëzve që i evidentojmë duhen ditur këto por edhe vendlindja e numri i telefonit. Pranë emrit të tyre, sipas përshtypjeve të Grupit Punues të Qendrës së VETËVENDOSJE!-s, duhet vendosur njëra nga këto katër shenja:

+ (pozitiv), - (negativ), 0 (neutral), ? (duhet pyetur më shumë për të).

Ky skanim prodhon radiografinë e komunave. Pasi Qendrat t'i kryejnë mbi 75% të punëve të evidentimit, do të fillonim me takimet. Paraprakisht, pra qysh tash, bëhet plani për takimet me njerëzit e përzgjedhur nga Grupi Punues përkatës i secilës Qendër duke u bazuar në skanimin e kryer. Përpilohet një kalendar i këtyre takimeve i planifikuar mirë.

Takimet zhvillohen nga anëtarët e kryesisë, deputetët dhe aktivistë të shquar të Sekretariatit të Përgjithshëm nga Prishtina, bashkë me dikë nga Grupi Punues i Qendrës. Njerëzit që i takojmë duam t'i informojmë për VETËVENDOSJE!-n, ta dëgjojmë mendimin e tyre për Lëvizjen tonë e deri te anëtarësimi e aktivizimi i tyre. Është e rëndësishme të mendohen detyra të llojllojshme për ta si për nga fushat e ndryshme po ashtu edhe për nga vështirësia e kryerjes së tyre. Nga njerëzit që vlerësohen negativisht, duhet të takohen ata të cilët kanë ndikim në komunën përkatëse dhe flasin keq për VETËVENDOSJE!-n, qoftë publikisht apo edhe vetëm privatisht. Ata duhen takuar dhe shpjeguar për qëndrimet, angazhimet dhe idetë e Lëvizjes sonë, pavarësisht sa e kotë mund të duket një gjë e tillë.

Kësisoj, do ta fillojmë një lëvizje brenda Lëvizjes e cila e decentralizon udhëheqjen në Prishtinë për zgjerim dhe dinamizim nëpër Qendrat e VETËVENDOSJE!-s.

Qendra e Prishtinës duhet të organizohet veçmas, jo pse Prishtina është kryeqytet sa për shkakun se aty e kemi ne qeverisjen komunale. Kuzhinat popullore për të varfërit (edhe duke grumbulluar ushqimin që hidhet nga restorantet) dhe biznesi i rrjetit të shpërndarjes për qumështin e freskët nga blegtorët e komunës (në bashkëpunim me Drejtorinë e Bujqësisë) janë të nevojshme.

Mitrovica është në gjendjen më të rëndë: qyteti më i varfër i Kosovës përkundër pasurive dhe potencialit të Trepçës, qyteti me urën më të madhe që vazhdon të mbetet i ndarë, qyteti të cilit i janë hedhur sipër, edhe Serbia edhe ShIK-u. Të dyja këto janë shumë të fuqishme në Mitrovicë ndërkohë që nuk bëjnë luftë me njëra-tjetrën. Duket që ndarja e Mitrovicës në Kosovën e pasluftës i bashkon ata. Qendra e VETËVENDOSJE!-s atje duhet të jetë po ashtu më e veçantë.

Gjithnjë duhet ta kemi parasysh tërësinë e organizatës si burim njerëzor. Nuk guxojmë që ata të cilët nuk i kemi parasysh (fizikisht), të mos i marrim parasysh (politikisht), dhe të mos u ndajmë detyra. Nuk ka detyra pa aktivistët dhe nuk ka as aktivistë pa detyra!

Victor Hugo thoshte që ka njerëz që janë hekur dhe njerëz që janë magnet. Neve na duhen të gjithë këta njerëz, sepse duhet të qëndrojmë të fortë kur rezistojmë e të jemi të fortë kur godasim, por edhe t'i tërheqim njerëzit e tjerë prej hekuri teksa zgjerohemi e rritemi.

Ideja është alternativë

E vërteta dhe e drejta janë në anën tonë. Prandaj ne do të fitojmë. Kjo do të thotë se as ne nuk do të fitojmë pse jemi ne, por pse jemi në rrugë të drejtë – jo pse kemi emrat që kemi e pse jemi këta njerëz të përveçëm, por pse ideja udhërrëfyese dhe koncepti bazë janë universal kurse programi politik më i miri dhe më i duhuri për popullin dhe vendin tonë.

Organizimi ynë është bazuar në idenë e vetëvendosjes dhe ekziston për ta përmbushur vetëvendosjen si koncept. Pra, organizimi i Lëvizjes VETËVENDOSJE! ka për themel ideor vetëvendosjen dhe, njëkohësisht, vetëvendosjen e ka për mision të vetin politik.

Vetëvendosja nënkupton dy gjëra: nënkupton një vehte, e cila është populli; dhe, një vendosje, e cila është e popullit për veten e tij. Ideja e vetëvendosjes ngërthen në vetë subjektin dhe lirinë. Subjektin i cili është i tillë për shkak të lirisë që ka dhe lirinë e cila është aty për shkak të subjektivitetit.

Ne fillojmë ta rikuptimësojmë edhe politikën duke e përcaktuar atë, jo thjesht si përfaqësim e ndërmjetësim, siç ishte deri në vitin 2005, por para së gjithash si vizion dhe si aksion. Pra, Lëvizja VETËVENDOSJE! nisi si një intervenim subjektiv politik, i bazuar në një ide universale, siç është ajo e vetëvendosjes, e cila frymonte historikisht në popullin tonë dhe organizonte rrjetin e aktivistëve tanë duke u mishëruar në aksione politike të drejtpërdrejta në sferën publike.

VETËVENDOSJE! vazhdimisht ka ecur përpara pa nostalgji për të kaluarën, pa melankoli në të tashmen dhe me vetëbesim drejt së ardhmes. Me një vetëbesim që nënkupton se e ardhmja nuk është një stacion që na pret, por e ardhmja është një hapësirë që e krijojmë dhe një kohë që e fitojmë.

“Idetë sundojnë botën. Dhe çdo ide ka një të shkuar të largume, që humbet në retë e një fantazie të dëshpëruar. Çdo ide ka edhe një burim të thjeshtë, që u përngjan ndjenjave të pafajshme të djemve të vegjël. Çdo gjë që bëhet rreth e rrotull nesh, çdo gjë që u bë u bë dje, çdo gjë që bëhet tani, nuk është gjë tjetër përveç se një vazhdim i paprerë lufte midis ideve. Historia e njerëzisë është historia e ideve. Si djemtë e vegjël bëhen burra të mëdhenj, ashtu edhe ëndrrat, burimet e para të ideve, rriten, ngjallen, gjigantohen dalngadalë dhe krijojnë rrymat e mëdha ideologjike, realitetet e mëdha shoqërore, që caktojnë fatin e botës. Dhe kur të vijë kjo ditë, çdo lëvizje reaksionare bëhet më qesharake. Përparimi bëhet Ligj. Dhe ky ligj ushtron absolutizmin e tij.” – Branko Merxhani

Nga Manifesti të Programi Politik dhe nga Programi Politik të Alternativa Qeverisëse. Ky është rrugëtimi konceptual i Lëvizjes VETËVENDOSJE! i cili ka ndryshuar sepse është thelluar e zgjeruar. Demokracia në institucione e në shoqëri, sovraniteti në shtet dhe territor, prodhimi e punësimi në ekonomi, drejtësia e ligji për barazi, kontributi e përkujdesja për mirëqenie, janë radhitur në 20 kapitujt e Alternativës sonë Qeverisëse. Nga idetë të kritika, nga kritika të qëndrimet dhe nga qëndrimet të zgjidhjet.

Në këtë alternativë janë elaboruar gjerë e gjatë, shteti republikan dhe sundimi i të drejtës, politikat fiskale dhe mbrojtja sociale, sistemi pensional dhe sigurimet shëndetësore, punësimi dhe investimet, arsimit dhe shkenca, industria dhe bujqësia, sektori privat dhe ndërmarrjet e biznesit, mbrojtja e vendit dhe siguria për qytetarët, politika e jashtme dhe reciprociteti, integrimi evropian dhe mërgata, pushteti lokal dhe planifikimi hapësinor, kultura dhe trashëgimia kulturore, edukimi dhe sporti.

Ne e shohim shtetin si Republikë dhe ne e duam shtetin si republikë. Republika na mundëson që të jemi qytetarë me të drejta, punëtorë me mirëqenie, njerëz të arsimuar dhe banorë të shëndetshëm. Republika e Kosovës e shpallur më 2 korrik 1990 ishte Republika e Parë e Kosovës si republikë-për-rezistencë. Pavarësia e Kosovës e shpallur më 17 shkurt 2008 ishte Republika e Dytë e Kosovës që doli të jetë Republikë-për-shitje. Ne

kemi nevojë për Republikën e Tretë të Kosovës që ta shpëtojmë Republikën si të tillë. Pra, për Republikën e Tretë si Republikë për drejtësi e bashkim, për demokraci e zhvillim, për barazi e mirëqenie. Kjo nënkupton transformim të shtetit të Kosovës dhe jo vetëm reforma të institucioneve të sistemit. Shtetit të Kosovës duhet t'i hiqet kufizimi që ia ndalon bashkimin me Shqipërinë, duhet t'i hiqet korrupsioni që i ka delegjitimuar institucionet, duhet t'i hiqen negociatat me Serbinë që e kanë gjymtuar shtetin, duhet t'i hiqet privatizimi abuziv që e ka shpronësuar popullin, duhet t'i hiqet papunësia e varfëria që e kanë poshtëruar e mjeruar qytetarin e Kosovës.

Shteti i së Drejtës, në konceptimin tonë, fillon prej aktualizimit të vetëvendosjes, prej kushtetimit modern të shtetit tonë, ku Sovran duhet të jetë populli, si në gjithë shtetet demokratike. Shteti i së drejtës duhet të jetë republikan dhe Republika duhet të jetë vlera më e lartë politike. Ajo simbolizon të përbashkëtën, terrenin e vetëm ku garantohet edhe liria e përgjegjësia e individuale.

Shteti i Zhvillimit Ekonomik nuk mbetet spektator i tregut të lirë por angazhohet si faktor e aktor duke orientuar dhe nxitur ndërmarrje e sipërmarrje ekonomike që i sjellin vlerë të shtuar financiare dhe materiale vendit tonë. Prodhimi bujqësor, industrial e zejtar duhen ndihmuar e përkrahur nga qeveria që të zëvendësojnë e zvogëlojnë importet, të rrisin punësimin e qytetarëve dhe akumulimin e kapitalit.

Shteti i Mirëqenies Shoqërore është universal, pra, të gjithë ata që kanë të ardhura duhet të paguajnë taksa dhe të përfitojnë të gjithë ata që kanë nevojë; dhe, është solidar, pra kontributi i gjithsecilit do të jetë në progresion me të ardhurat që përfiton dmth. ata që fitojnë më shumë, kontribuojnë më shumë për të mirën e përgjithshme. Përderisa kujdesi shëndetësor dhe arsimimi varen kaq shumë nga të ardhurat dhe klasa shoqërore s'mund të bëhet fjalë as për drejtësi e as për mundësi të barabarta. Tatimi progresiv do të thotë që shpatullat e fuqishme duhet të bartin më shumë peshë sesa shpatullat më të dobëta.

Zgjidhjen, Lëvizja jonë e sheh në lëvizje të përbashkët politike e shoqërore të të gjithë qytetarëve drejt bashkimit organik të aspektit të së drejtës, të zhvillimit dhe atij social të shtetit. Shteti i së Drejtës, Shteti Zhvillimor dhe Shteti Social janë të ndërlidhura në jetë e në shoqëri, prandaj ne i paraqesim ato të bashkëlidhura në vizione dhe për institucione. P.sh. respektimi i ligjit për kohëzgjatjen e orarit të punës e rrit punësimin dhe rrjedhimisht mirëqenien. Kur njerëzit nuk punojnë më nga 10 a 12 orë në vend se 8, duhen punësuar më shumë punëtorë të rinj. Kësisoj, Shteti i së Drejtës dhe ai Social shfaqen bashkë. Ose, luftimi i evazionit fiskal rrit bazën tatimore e investimet serioze dhe kur kësaj i shtohet tatimi progresiv mundësohet shumëfishimi i mjeteve buxhetore që i dedikohen gjyqësorit e prokurorisë. Kësisoj, Shteti i së Drejtës dhe Shteti Zhvillimor shfaqen po ashtu bashkë. Ose, zvogëlimi i tatimit në të ardhura për punëtorët që inkadrohen në sindikata dhe paguajnë anëtarësinë aty, jo vetëm që e rrit organizimin e tyre dhe e zvogëlon shfrytëzimin, por edhe i nxit punëdhënësit për vizion më afatgjatë që stabilizon rritjen e ndërmarrjes dhe përfitimin e biznesit. Kështu, Shteti Zhvillimor dhe ai Social shfaqen bashkë.

Nuk ka demokraci pa Republikë dhe nuk ka demokraci pa socialdemokraci. Sepse në Republikë populli është burim i sovranitetit (për dallim prej monarkisë ku është mbreti)

dhe popullsia është, në shumicën e saj dërrmuese, e varfër ose e klasës së mesme. Socialdemokracia angazhohet që të bëhet zhvendosja e balancit të fuqisë nga kapitali te puna.

Ky shtet i shumicës është i vetmi që mund të garantojë të drejtat e pakicave në kuptimin modern dhe evropian të fjalës. Çdo shtet i pakicës, qofshin ata politikanë shqiptarë që u bënë multimilionerë, qofshin ata burokratë ndërkombëtarë me fuqi ekzekutive e imunitet prej ligjit, qofshin ato përfaqësues të pakicave kombëtare me të drejtë vetoje bllokuese, pra çdo shtet i pakicës sikurse ky që kemi sot, është pengesë për demokracinë dhe funksionimin si në drejtësi, po ashtu edhe në ekonomi e shoqëri.

Alternativa Qeverisëse e VETËVENDOSJE!-s garanton qeverisje alternative nga Lëvizja jonë. Alternativa e VETËVENDOSJE!-s e bën Lëvizjen tonë alternativë. Kjo Alternativë është për popullin e Republikës së Kosovës dhe kundër kaosit strategjik që mbretëron në Kosovë. Kemi kaos sepse kemi këtë qeveri që sundon. Dhe, ky kaos është strategjik sepse kemi dominimin e neoliberalizmit brutal në ekonomi dhe të pazareve të pafundme me Serbinë në politikë.

Ne bashkimin kombëtar nuk e duam si bashkim kombëtar kundër serbëve, por e duam për hir të shqiptarëve, lirisë së tyre si komb, barazisë së tyre me kombet e tjera dhe njëkohësisht paqes, sigurisë e stabilitetit afatgjatë në Ballkan.

Në pyetjen e cila i vendos përkundruall zhvillimin ekonomik dhe drejtësinë sociale, Alternativa Qeverisëse e Lëvizjes VETËVENDOSJE! është përgjigja. Alternativa Qeverisëse është për Shtet Republikan për drejtësi e bashkim, dhe, për Social-demokraci për barazi e zhvillim.

Lëvizja VETËVENDOSJE! duhet që edhe më tej Alternativën e saj Qeverisëse ta lexojë, ta rilexojë, ta mësojë, ta shpërndajë, ta afirmojë sa më shumë që është e mundur, sepse ky është një program me fitoren e së cilës fitojmë të gjithë ne, e, rrjedhimisht, secili prej nesh.

Organizimi është bashkim dhe bashkëpunim i strukturuar i aktivistëve të rrjetit të VETËVENDOSJE!-s. Ne duke e forcuar organizimin tonë e rrisim fuqinë goditëse të strukturave tona, në përputhje me konceptin tonë, e për qëllime të cilat derivojnë prej këtij koncepti. Koncepti ynë politik na mban në rrugë të drejtë kurse nismat tona të vazhdueshme na mbajnë aktiv. Duhet të punojmë edhe më shumë se deri më tash, pa e humbur durimin. Dhe, duhet të jemi edhe më aktivë se deri më tash, duke u bërë gjithnjë e më shumë bashkë. Idesë e ideve tona të fuqishme ne duhet t'ua bashkangjesim një organizatë të fuqishme.

Organizata e VETËVENDOSJE!-s është masa vlerësuese e VETËVENDOSJE!-s në institucione. Duke qenë se na është rritur dhe fuqizuar organizata e Lëvizjes, kjo dëshmon dobinë dhe drejtësinë e Lëvizjes në institucione. Me hyrjen e Lëvizjes VETËVENDOSJE! në institucione nuk ka ndryshuar Lëvizja VETËVENDOSJE! por kanë ndryshuar institucionet. Institucionet janë demokratizuar dhe janë politizuar.

Pa Lëvizjen VETËVENDOSJE! në institucione, ato do të ishin shumë më pak demokratike dhe shumë më pak politike. Pra, pjesëmarrja e Lëvizjes VETËVENDOSJE! në institucione ka qenë veprim shtesë për Lëvizjen dhe qenie të re për institucionet, e jo anasjelltas.

Nëpër beteja insitucionale e jashtëinstitucionale, Lëvizja VETËVENDOSJE! po kalitet drejt fitores së saj. Do të ketë shumë vështirësi që vijnë prej njerëzve të regjimit që kanë vjedhur para për të vjedhur vota dhe kanë vjedhur vota për të vjedhur para. Por ama edhe sa më shumë që do të na e vonojnë fitoren, aq më të madhe do ta kenë humbjen.

Lëvizja jonë është lëvizje e vullnetit prandaj organizata jonë është organizatë e vullnetarëve. Ne jemi vënë në lëvizje nga ideja e vetëvendosjes dhe e kemi bërë këtë ide një lëvizje që gjithmonë do t'i shërbejë popullit tonë për të vendosur vetë. Askush nuk ka të drejtë të marrë vendim sikurse populli.

Lëvizja VETËVENDOSJE! është i vetmi subjekt i cili nuk e rrit fuqinë në Kosovë duke u shkëputur nga populli. Pra, vetëm te Lëvizja kemi rritje të fuqisë pa rënie të prestigjit. Kur VETËVENDOSJE! vjen në pushtet kjo tashmë do të thotë që pushteti i është afruar popullit shumë pranë.

Ne jemi demokratë që përpiqemi ta shpëtojmë popullin dhe idenë për të nga popullizmi, ndërkaq analistët e regjimit janë elitistë që kinse sulmojnë popullizmin për të sulmuar, në fakt, vetë popullin. Ne e duam lirinë e popujve dhe njerëzve por atë nuk ia kundërvëmë lirisë së individit teksa duam që lirinë politike ta shpëtojmë nga tregu. VETËVENDOSJE! ka përvetësuar edhe dy teza themelore të idesë liberale sipas John Lockut që thonë se: 1) kontrata shoqërore konsiston në heqjen dorë nga të drejtat natyrore për t'i rifituar ato si të drejta qytetare; 2) liria është e lidhur me idenë e zhvillimit.

Aq e rëndë është gjendja në Kosovë, saqë ndryshimi i vogël nuk është ndryshim. Tashmë për ndryshim të vogël nuk ia vlen të përpiqemi. Për ndryshim të madh nevojitet vetëmohim, që do të thotë, shumë punë e angazhim. Deri më tani, ata që e kanë dashur VETËVENDOSJE!-n, e kanë dashur ndryshimin. Tani, ata që e duan ndryshimin, po e duan VETËVENDOSJE!-n. Drejtësia e konceptit, alternativa qeverisëse, angazhimi i dendur, qëndrueshmëria në rezistencë, guximi në aksion, konsistenca e diskursit dhe serioziteti në punë janë edhe dëshmi edhe garanci se VETËVENDOSJE! quhet ndryshimi në Kosovë.

Ne nuk duhet ta kërkojmë atë që është e mundur por duhet ta bëjmë të mundur atë që po e kërkojmë. Bashkësia e lind shpresën sepse e lind mundësinë. Dhe, mandej, bashkë realizohen mundësitë. Duhet të bëhemi bashkë për shtet të bashkuar që bashkon. Unë-në-bashkësi dhe bashkësia-në-mua – këtë duhet ta gjejë secili.

Lëvizja është shumë më e madhe sesa çdonjëri prej nesh, Lëvizja është më e madhe edhe sesa të gjithë ne së bashku, prandaj të gjithë ne bashkë, prandaj secili me njëri-tjetrin, duhet të lëvizim edhe shumë, edhe gjatë, edhe drejtë, edhe mirë, edhe pandalshëm, përpara!

Organizata është fuqi

Organizata është rrjet i aktivistëve të cilët janë të orientuar për nga qëllimi, i koordinojnë aktivitetet, i ndajnë punët dhe sigurojnë vazhdimësi përgjatë kohës, pavarësisht ndryshimeve në anëtarësinë individuale.

Fuqia jonë politike vjen nga organizata e Lëvizjes dhe vlera e konceptit, nga gjerësia organizative dhe thellësia e bindjeve, nga puna e parrezervë dhe kontributi i pakursyer, e jo nga fama e personaliteteve të Lëvizjes.

Njerëzit vijnë në Lëvizjen VETËVENDOSJE! sepse: 1) përkrahin idenë tonë politike dhe konceptin socio-ekonomik; 2) pëlqejnë aktivitetet dhe aksionet tona; 3) kanë ndonjë shoqe apo shok në Lëvizjen tonë; 4) zemërimi ua ka tejkaluar pragun e durimit.

Njerëzit janë të përkushtuar në organizatën e Lëvizjes sonë sepse kanë: 1) Përkushtim afektiv për shkak të qëndrimit pozitiv ndaj organizatës; 2) Përkushtim normativ nga ndjenja e obligimit ose detyrës; 3) Përkushtim të vazhdimësisë për shkak të mungesës së alternativave më të mira.

Institucionet e sistemit e rezistojnë ndryshimin. Organizata e Lëvizjes angazhohet për të. Organizata kështu na shfaqet në kontrast me institucionet e sistemit më parë sesa me strukturën organizative. Diskutimi e vendimmarrja në Lëvizje duhet të jenë në forume dhe struktura, e jo me lobim, pa përgjegjësi dhe pa punë.

Struktura organizative ka të bëjë me përgjegjësitë e punës dhe me marrëdhëniet e autoritetit të cilat kanë ndikim në sjelljet në organizatë dhe vendimet që merren. Kultura organizative ka të bëjë me vlerat që i ndajnë aktivistët në organizatë. Përgatitjet për aktivitete dhe protesta duhet të jenë praktikë dhe ushtrim i punës ekipore.

Kur nuk ka kanalizim, nga reshjet ngjan vërshimi. Ngjashëm, elektriciteti statik në ajër nuk ndriçon përveçse si rrufe shkatërruese. Energjia e tillë potenciale për t'u bërë fuqi e dobishme ka nevojë për rrjetin e gypave, përkatësisht për rrjetin kabllor elektrik. Rrjeti, që politikisht i bie organizimi, paraqet kushtin dhe mundësinë për fuqinë e dobishme.

Organizatën e bën të fuqishme:

- 1) Llojllojshmëria e detyrave konkrete që ajo ndan (sipas çështjeve dhe vështirësisë);
- 2) Përzgjedhja e aktivistëve adekuatë për kryerjen e tyre;
- 3) Diciplina e brendshme që i shtrëngon radhët;
- 4) Komunikimi i brendshëm i pandërmjetësuar nga mediet publike.

Organizata është organizim permanent. Organizata është organizatë sepse është e aftë të organizojë shumë punë e aktivitete njëkohësisht. Detyrat e punës në Lëvizje janë të llojit organizativ, përmbarues, përfaqësues dhe elektoral.

Ndarja e qartë e punëve është vendimtare. Këtu lëngon ende Lëvizja VETËVENDOSJE!. Ajo nuk e ka ndarjen e punëve mjaftueshëm të thellë andaj shumica e aktivistëve janë më shumë spektatorë të aksioneve dhe aktiviteteve të Lëvizjes në përgjithësi sesa të kredhur thellë në punën e tyre të veçantë.

Prej Kryesisë, Grupit Parlamentar, Sekretariatit të Përgjithshëm, Komiteteve, Nënkomiteteve dhe Grupeve Punuese duhet të dihet më konkretisht dhe saktësisht se kush çka punon, para se të dihet sa po punon. Pabarazia në punë në organet e VETËVENDOSJE!-s midis aktivistëve duhet të jetë shprehje e përgatitjeve të tyre, e aftësive të tyre, e jo e përkushtimit subjektiv apo përcaktimit arbitrar të tyre. Natyrisht që ndarja e punëve nuk do të thotë se nuk ka punë të njejtë e të përbashkët.

Organizata e VETËVENDOSJE!-s duhet të jetë jo vetëm për aksion por edhe për aktivitet, jo vetëm për aktivitet por edhe për punë. Në fazën e ristrukturimit, puna (pa zhurmë) organizative është më e rëndësishme sesa aksionet (publike) të Lëvizjes. Supa ngrohet shpejt me mikrovalë, mirëpo buka piqet ngadalë në furrë. Ngrohja e supës është aksion i Lëvizjes. Pjekja e bukës është punë organizative. Aktivisti njëmend duhet të ketë mosdurim ndaj padrejtësisë por ai patjetër duhet të ketë durim në punë.

Në ristrukturim, çdo sektor dhe nivel i Lëvizjes duhet ta zvogëlojë punën nëpër zyra. Nga pesë ditë pune nuk ka kurrfarë mundësie që të jenë të nevojshme për të qëndruar në zyre më shumë sesa dy sosh. Aktivistët më të mirë s' duhet të bëjnë punë zyresh por të takojnë qytetarë. Paulo Freire thoshte që aktivizmi revolucionar nënkupton komunikimin me popull pa komunikatë. Aty ku njerëzit janë tubë, me pjesëmarrjen e aktivistit të Lëvizjes, bëhet tubim.

Duhet rritur shumë pagesa e anëtarësisë kurse shpenzimet për paga dhe qiratë e zyrave duhet t'i sjellim nën 50%, me synimin që të jenë më së shumti 1/3 e shpenzimeve në një plan afatmesëm. Qendrat tona janë në nivele të ndryshme zhvillimi. Lëvizja duhet të shpenzojë më së shumti në ato qendra të saj dhe në ato drejtime ku maksimizohet potenciali(teti).

Aktivistët bëjnë takim pune vetëm atëherë kur:

- 1) Bisedojnë edhe me dikë që nuk është anëtar i Lëvizjes VETËVENDOSJE!;
- 2) Ndajnë, marrin dhe/ose japin llogari për detyrat (e kryera);
- 3) Analizojnë bashkë situatën politike prej nga burojnë shkrime për protale apo gazeta dhe/ose ide kreative për aksione simbolike apo aktivitete publike.

Për çdo takim duhet ditur temat e bisedës dhe qëllimi. Nga çdo takim duhet parë çfarë përfiton Lëvizja jonë. Ne insistojmë ca tepër tek njerëzit duke i trajtuar ata kolektivisht dhe tepër pak kur i takojmë e bashkëbisedojmë me ta individualisht. Kjo duhet ndryshuar.

Duhet të mbikëqyret vazhdimisht kryerja e detyrave dhe obligimeve ditore, javore e mujore të aktivistëve dhe anëtarëve. Duhet të dihet se kush, sa, si e kur po punon. Në përputhje me këtë duhet të kemi vlerësim dhe ndëshkim, lëvdatë dhe qortim.

Duhet patur një program të qartë për qytetarët që anëtarësohen në VETËVENDOSJE!: çka duhet bërë me ta në ditën e parë kur anëtarësohen, çka në javën e parë e çka në muajin e parë? Shoqërimi me aktivistët e rinj në muajin e parë të anëtarësimit të tyre është shumë i rëndësishëm.

Duhet patur një listë të detyrave konkrete për ata që janë simpatizantë të Lëvizjes, që e votojnë Lëvizjen por nuk anëtarësohen në të. Si dhe një listë të detyrave për kundërshtarët e këtij regjimi e sistemi në përgjithësi. Madje, duhet të kalojmë edhe nga detyrat konkrete te detyrat specifike. Sepse edhe detyrat konkrete të depolitizojnë po mbete i kufizuar tek ato.

Aktivisti duhet të punojë me rrethin e tij familjar, profesional e shoqëror. Aktivistët e Lëvizjes duhet t'i emancipojnë anëtarët e familjes së tyre. Duhet t'i pyesim e të tregojnë se për kë votojnë anëtarët e familjes. Udhëheqja duhet t'i vizitojë aktivistët e anëtarët edhe nëpër shtëpitë e tyre sipas rasteve. Mbështetja e familjes për aktivistin e anëtarin është shumë e rëndësishme. Kur sindikatat e punëtorëve janë të dobëta ndërsa shoqëria civile është e shitur, familja bëhet mbrojtja kundrejt individualizmit dhe varfërisë.

Pikat e VETËVENDOSJE!-s si niveli i parë organizativ e lidhin Lëvizjen me qytetarët si masë prej qindra mijëra individësh njëkohësisht. Pikat janë tentakulet e shumta përmes të cilave Lëvizja flen në popull dhe populli zgjohet si Lëvizje. Punët kryesore të Pikës së VETËVENDOSJE!-s duhet të jenë: 1) Mbledhja politike, 2) Aktivitetet dhe aksionet, 3) Zhvillimet sociokulturore në Pikë dhe 4) Informimi i qytetarëve.

Ne e kemi idenë se kush janë votuesit tonë, mirëpo nuk i njohim ata. Organizata është ajo që njihet me votuesit. Ajo lidhet e kontakton me ta, drejt komunikimit e bashkëpunimit me ta. Kësisoj, votuesi mobilizohet dhe angazhohet për punë e në aktivitete.

Kryesia e Lëvizjes VETËVENDOSJE! përpilon strategji politike për një javë dhe për një muaj përfshirë këtu: përgjigjet për ngjarjet politike, përcaktimin ose konfirmimin e qëllimeve politike afatshkurta dhe afatgjata, pranimin e sugjerimeve nga Komitetet, dhe rishikimin e qëllimeve të arritura. Te aktivitetet ajo propozon se si të prezantohen qëllimet politike dhe mandej bëhet raporti mbi suksesin dhe efektin e aktiviteteve të përfunduara. Kjo shoqërohet me strategji mediatike për prezantimin e qëndrimeve, qëllimeve dhe aktiviteteve tona si dhe me raportin përkatës të kësaj.

Nëpër Qendrat e VETËVENDOSJE!-s treshja udhëheqëse është kyçe: Koordinatori i Qendrës, Sekretari Organizativ dhe Koordinatori i Nënkomiteteve. I pari shënon drejtimin politik dhe përfaqësimin publik; i dyti organizatën në terren dhe strukturën e aktivistëve; i treti, politikat lokale sipas fushave profesionale.

Grupi punues i Qendrës nuk është kryesi. Grupi punues është grup duke qenë i punës. Prin me punë në terren e jo me hierarki në zyrë. Anëtarët e tij identifikohen me punën që bëjnë e jo me pozitën që marrin, madhësinë e grupit apo famën e pjesëtarëve të tij. Ne duam t'i bëjmë anëtarët aktivistë të Lëvizjes duke qenë të vetëdijshëm se edhe jo pak aktivistë do të bëhen vetëm anëtarë, kryesisht për shkak të mungesës së përkushtimit në punë.

Komunat nëpër Kosovë kanë shumë më pak ngjarje politike e jetë socio-kulturore krahasuar me Prishtinën. Profesorët e shkollave të mesme dhe arsimtarët e shkollave fillore përbëjnë shtresën intelektuale atje që përgjithësisht është e varur nga pushteti komunal, përkatësisht drejtorja e arsimit aty. Depërtimi te gjimnazistët është më i

kollajshëm duke mos harruar që ata duhen lidhur me Qendrën “Studim, Kritikë, Veprim” pasi që së shpejti do të bëhen studentë.

Zyrat e Lëvizjes nëpër komuna duhet të jenë të pastra dhe të mirëmbajtura mirë me rregull e diciplinë. Qytetarët dhe anëtarët aty duhet të mirëprehen nga aktivistët të dalluar të cilët kujdestarojnë dhe shquhen për njohuritë dhe dashamirësinë e tyre. Nuk mund të lejojmë që njerëzit që na vizitojnë të mos mbeten me përshtypje të mira nga zyret tona.

Sekretariati i Përgjithshëm i VETËVENDOSJE!-s duhet që me shumë kujdes të përzgjedh aktivistët të cilët inkuadrohen nëpër sekretariate dhe posaçërisht ata me përgjegjësi më të larta. Duhet trajtuar me kujdes karakterin e aktivistit që duam ta angazhojmë dhe karakteristikat e nevojshme për pozicionin gjegjës. Analiza e aktivistit duhet të përfshijë edhe suksesin e tij në shkollim e studime. Jo vetëm se kjo tregon shumë gjëra për atë aktivist, por edhe qytetarët kanë ndjeshmëri të lartë për rastet kur ata që ishin studentë të dobët ngjiten lart ose shpejt në hierarki.

Strategjia është parim

Ta kuptosh botën para se ta ndryshosh atë do të thotë ta menaxhosh atë. Ta kuptosh botën duke e ndryshuar atë do të thotë ta kuptosh atë. Në matematikë, në gjeometrinë e Euklidit, rruga e drejtë është rruga më e shkurtër midis dy pikave. Jo edhe në politikë, kurrsesi në Kosovë.

Me kalimin e kohës Lëvizja VETËVENDOSJE! ka ndryshuar, në kuptimin që e ka thelluar konceptin dhe e ka zgjeruar strategjinë. Madje, ne vazhdimisht ndryshojmë sepse ndryshon strategjia e rrethanat, ndërkaq parimet e qëllimet, koncepti e programi mbesin po ato. Ne e kemi strategjinë parimore dhe jo parimësinë strategjike. Besojmë në ndërmarrjen tonë si të drejtë para se të besojmë në dobinë e saj.

Një subjekt politik që nuk ka bazë teorike s’ mund të ketë strategji dhe vazhdimisht bën gabime taktike. Në anën tjetër, strategjia është dislokim i forcave. Nuk mund të bësh strategji pa kurrfarë njohurish mbi strategjinë ushtarake dhe atë të luftës. Dhe, më parë sesa të konsekuenca e tij, aksionin tonë duhet ta lokalizojmë te sekuenca së cilës ai i përket në kuadër të strategjisë dhe qëllimeve tona.

Parimet janë skeleti. Mishi është strategjia. Mishi pa skelet është absurditeti i masakrës ose pështirja nga kanibalizmi. Skeleti pa strategji është figurë horrori e vdekjes. Kur mishi është bashkë me skeletin kemi gjallesën dhe gjallërinë. Parimet pa strategji s’janë të gjalla. Parimet pa strategji janë të pastra pors i xhenazja pasi e lan atë hoxha.

Lëvizja jonë ka strategji, por në situata konkrete ajo zgjerohet dhe dikush nuk i sheh e dikush nuk dëshiron t’i shohë më parimet tona. Parimet tona janë të mbështjellura me strategji sikurse skeleti i njeriut me mishin e trupit. Aty ku kjo nuk ndodh kemi ngecje. Aktivistët tonë janë të mirë pors i buka, mirëpo bukë thatë nuk hahet gjithnjë. Aktivistët e VETËVENDOSJE!-s biejnë shumë në sy, ndërkaq ata të PDK-së e LDK-së fare pak ose aspak. Ne duhet të bëhemi më të sofistikuar.

Pastërtia morale e aktivistit të Lëvizjes nuk është qëllim por mjet. Pastërtia është vlerë në dritën e një synimi që e kemi, jo vlerë në vetvete. Njeriu mund ta ketë edhe si njëloj prirjeje që mjetin ta kthejë në qëllim. Ne nuk duhet ta fetishizojmë mjetin duke e bërë qëllim dhe nuk duhet të obsesionohemi me pastërtinë tonë. Te aktivizmi ynë, aktivisti politik yni nuk duhet të shihet si subjekt i dezinfektuar, si punëtor barnatoreje. Neve nuk na duhet aktivisti politik si subjekt higjienik e sanitar. Le ta kemi të qartë që kurdo që ta marrim pushtetin duhet ta kemi ndërgjegjen të pastër, por vaj halli nëse nuk i përlyejmë duart. Duhet ta ruajmë pastërtinë, por mos ta kuptojmë atë si qëllim në vetvete. Nëse e shohim pastërtinë në atë aspekt bëhemi egoistë.

Pra, ne i duam parimet jo pse janë parime por pse besojmë që na çojnë te qëllime të vlefshme e rezultate të dobishme. Të përpiqesh ta ruash Lëvizjen VETËVENDOSJE! në njëfarë parimësie të ngurtë të saj, do të thotë t'i tradhëtosh qëllimet e saj. Ne i besojmë vetes tonë, ne i besojmë vetvetes. Ne kemi bërë kompromise taktike për të ecur drejt qëllimit tonë e jo kompromise me parimet për përfitime individuale.

Edhe kur në vitin 2010 kemi marrë pjesë në zgjedhje parlamentare për herë të parë dhe kemi hyrë në institucione na thoshin që kemi shkëlur parime. Veprimet tona janë strategji e pasuruar për qëllimin e njëjtë e brenda konceptit të njëjtë. Madje, disa aq shumë kanë vajtuar për parimet e Lëvizjes VETËVENDOSJE! thua se kanë qenë ditë e natë me Lëvizjen në çdo aktivitet të saj. Pastërtinë tonë morale e kemi për ta përdorur e jo për dekor, siç do të dëshironin disa që po na shajnë.

Sulmet mbi neve janë të palogjikshme. Kur patëm hyrë si deputetë në Kuvend thoshin se e pranuan edhe ne pavarësinë e Kosovës sipas Ahtisaarit, kurse tash na thonë se nuk po e njohim pavarësinë e Kosovës (duke ua përkujtuar qytetarëve se betimin e deputetit e kemi bërë me flamurin kombëtar shqiptar dhe jo me atë të Kosovës)! Mbi të gjitha, 'rreziku i diktaturës së Lëvizjes VETËVENDOSJE!' që trumbetohet nga kundërshtarët tanë, sidomos së fundmi, flet për vetë ata: ajo vjen nga pozicioni i pikëprerjes së cinizmit postmodern dhe druajtjes konservatore të tyre. Në Lëvizjen VETËVENDOSJE! s'ka asgjë misterioze, sekrete apo enigmatike. Kjo duket se është e pabesueshme.

Në asnjë mandat nuk është ndjekur nga publiku Kuvendi i Kosovës dhe seancat plenare sikurse në legjislaturën e katërt dhe të pestë. Sidomos për shkak të Grupit Parlamentar të VETËVENDOSJE!-s aty. Nuk ka ndryshuar Lëvizja, porse ka ndryshuar Kuvendi. Kuvendi ka lëvizur. Sivjet Lëvizja VETËVENDOSJE! e ka bashkuar opozitën dhe po i prin asaj. E hoqëm një ministër në muajin shkurt të 2015. Do të heqim edhe të tjerë deri në rrëzimin e qeverisë.

Aktivistët e VETËVENDOSJE!-s nuk kanë as dosje të korrupsionit dhe as kompleks inferioriteti ndaj zyrtarëve ndërkombëtarë e qeveritarëve vendorë. Sa më shumë strategji që kemi aq më shumë e sulmojnë Lëvizjen tonë. Në përgjithësi, VETËVENDOSJE!-n e sulmojnë pikërisht pse ajo mund të fitojë.

Strategjia dhe taktika duhet të pasurohen me një dimension shtesë. Nuk mund të kemi organizim legal në çdo vend ku mund të kemi organizim. Në komunat, lagjet apo fshatrat

ku klientelizmi është i lartë e varfëria e thellë, duhet përgatitur për organizim ilegal apo gjysëmlegal. Atje ku kontrolli dhe hakmarrja e pushtetit është e madhe, organizimi jopublik është edhe i imponuar por edhe i domosdoshëm.

Partitë e tjera janë të ngjashme në thelb porse jo edhe në secilin element përbërës të tyre, jo edhe në hollësitë e tyre. Janë të këqija, porse e keqja e tyre varet së paku nga pozita e tyre e cila s'është e njëjtë. Pra, edhe mund të jenë gati të njëllajta për nga karakteri, por gjithsesi janë tejet të pabarabarta për nga fuqia. Lëvizja jonë e ka bashkuar opozitën dhe po i prin asaj. Nga bashkëpunimi i VETËVENDOSJE!-s me partitë tjera, nuk ka ndryshuar Lëvizja por partitë tjera. Kurrë në historinë e saj 10 vjeçare VETËVENDOSJE! nuk ka peshuar më rëndë në politikën kosovare sesa tash. Dhe, për çdo ditë po na rritet rëndësia e po na shtohet fuqia.

Ideja e vetëvendosjes është e tillë sa që bën që parimet të mos jenë vetëm vlera (të pikënisjes) por edhe synime (që duam t'i realizojmë). Prandaj, jo vetëm që brenda strategjisë sonë janë parimet por edhe brenda parimeve duhet të jetë e do të jetë strategjia.

Beteja është jetë

Pushteti është më i vjetër se politika. Kosovës i nevojitet një politikë e re që tregon se sa i vjetër është ky pushtet. Vetëvendosja është zgjidhja, sepse vetëvendosja e shtron problemin siç duhet. Vetëvendosja nis si kusht i zgjidhjes së problemeve dhe nuk mbaron vetëm si garanci e zgjidhjes së tyre. Kudo në botë e në jetë, padrejtësia ndjehet, ndërkaq drejtësia imagjinohet. E drejta e vetëvendosjes është imagjinata e drejtë. Më shumë se vetëvendosja, është më pak se vetëvendosje.

Para se të jetë çështje shpejtësie, politika është çështje e një shtegu të përcaktuar botëkuptimi në të cilin koncepte e nocione përkatëse fitojnë stabilitet semantik dhe lidhen me njëra-tjetrën. Ato përbëjnë, më tej, tullat e programit politik. Me organizatë e nëpër beteja realizohet ai program, çdo program.

Organizata dhe beteja janë të lidhura ngushtë: organizata e Lëvizjes përfshihet në betejë politike për qëllimet e VETËVENDOSJE!-s por edhe korr rezultate organizative. Nuk ka betejë politike pa organizatën dhe organizata s'mund të jetë e njëjta pas betejës sikurse para saj (si në aspektin sasior po ashtu edhe në atë cilësor). Përgatitjet për beteja na bëjnë bashkë për beteja e në beteja.

Beteja jonë është vullnet për qëllim dhe strategji për fitore. Aktivisti i Lëvizjes nuk i frikësohet betejës. Sepse beteja është parakusht për ndryshimet që i duam. Dhe, nuk ka ndryshime pa rrezik. Njerëzit te ne rrezikojnë aq shumë në komunikacion duke vozitur shpejt e duke tejkalar paligjshëm. Pastaj, jo pak prej tyre ankohen për rrezikun në protesta! Njerëzit janë lodhur nga jeta e rëndë e jo nga protestat e shpeshta. Dhe, nga mungesa e protestave, jeta rëndohet edhe më tej. "Ai që rron, rron sepse e pa dhe e munda rrezikun. Jetë do të thotë ta mundësh rrezikun." - Branko Merxhani.

Ne ndoshta votohemi për shkak të dukjes (sonë), por veprimet për shkak të mendimit (tonë). Protesta dhe aksioni ta sigurojnë betejën. Kur kufizohesh te përfaqësimi institucional dhe zgjedhjet periodike duhet të presësh gjatë për 'betejën'. Ne edhe mund të digjemi, por ne nuk do të ndryshkemi.

Prej njerëzve të maskuar e të demaskuar të regjimit shpesh kërkohet nga ne që të jemi konstruktiv (sic.). Mirëpo, ne duhet të jemi destruktiv dhe kreativ: jo ndërtues (sipas planeve të tyre), por shkatërrues (të ngrehinave të tyre) dhe krijues (sipas ideve dhe alternativës sonë).

Demonstrata dhe aktiviteti në përgjithësi e shndërrojnë popullsinë në popull. VETËVENDOSJE! mund të ketë edhe politikë joprotestuese por çdo protestë e ka politike. Ekzistenca është protestë. Protesta është ekzistencë.

Për angazhimet tona mobilizuese e aktivizuese, e posaçërisht për ballafaqimet publike, duhet ta studiojmë mirë:

- 1) Përbërjen klasore, kulturore dhe profesionale të qytetarëve (protestues);
- 2) Kundërthëniet brenda regjimit në fuqi.

Organet e Lëvizjes sonë duhet t'i mobilizojnë shtresat e ndryshme të popullsisë dhe fusin në ballafaqim me regjimin. Zgjidhja për mobilizimin e qytetarëve është politizimi i cili është edhe jopartiak edhe tematiko-ideologjik. Rrjedhimisht, aksioni duhet të jetë i përbashkët me qytetarët dhe jo domosdoshmërisht idealet apo struktura. Me ta t'i kërkojmë zgjidhjet kolektive për problemet (në dukje) individuale.

Nevojitet shumë punë. Njerëzit që janë tejet gjatë tepër pasivë, pa u bërë ca të dhunshëm s'bëhen dot aktivë. Popullata e pasivizuar e di këtë, andaj aktiviteti ynë i duket përgjithësisht i dhunshëm. Duhet filluar nga detyrat më të lehta tek ato më të vështira. Në anën tjetër, nuk është kollaj as për një pjesë të aktivistëve tanë. Vendin e punës aktivisti i Lëvizjes VETËVENDOSJE! në sektorin publik, por shpesh edhe në atë privat, e mban me forcë sepse vendosmërisë së tij i frikësohet punëdhënësi.

Me Lëvizjen nëpër beteja duhet arritur në pikën kur flasim për popullin që nuk është populli i individit, popull në sytë e individit. Me VETËVENDOSJE!-n nëpër demonstrata duhet arritur në pikën kur popullsia në-vetete është bërë popull për-vete.

Nëpër takime me qytetarët, ata duhet bindur që ndryshimi është i mundur dhe atyre duhet t'iu hiqet frika. Por, edhe nuk duhet të brengosemi pse qytetarët nuk po na përkrahin me shumicë e masivisht. Sepse situata është e rëndë tejmase dhe për këso situatash populli na ka neve njerëzve të Lëvizjes. Vetëm ne mund ta zhgënjëjmë popullin dhe s'mund të ndodhë e kundërta. Vetëm ne mund të dështojmë dhe jo populli.

Nuk mund të presim që njerëzit dhe populli do ta organizojnë vetveten. Fillo dhe organizo – populli është duke e organizuar veten asisoj. Mos u vetëkonsidero kundrejt popullit, në kontrast me komunitetin a kolektivin e njerëzve të tjerë. Vepra individualisht si popull. Vepra edhe në emër të popullit.

Përshtypjet për Lëvizjen VETËVENDOSJE! shumica e qytetarëve i kanë me fusnotë. VETËVENDOSJE! ndodhet në një mjedis armiqësor si në aspektin politiko-kombëtar po ashtu edhe në atë socio-ekonomik, prandaj edhe duhet të punojmë jo pak që të mbesim kaq sa jemi. Ndërkaq, për t'u rritur, duhet të punojmë shumë.

Shumica dërrmuese e atyre që i bëjnë vërejtje thumbuese VETËVENDOSJE!-s, ose nuk janë mjaftueshëm të zemëruar me gjendjen e rëndë në Kosovë ose nuk janë përnjëmend të zemëruar. Mirëpo, ne nuk duhet t'i neglizhojmë ato vërejtje por t'i trajtojmë seriozisht e me durim.

Neve na akuzojnë duke shpifur dhe na sulmojnë duke gënjyer. Por, ne duhet ta kuptojmë se nuk ka pasur mundësi tjetër: regjimi dhe njerëzit e tij nuk kanë armë e mënyra të së vërtetës. Shpifja e gënjeshtër janë krejt çfarë kanë. Dhe, shpifja e gënjeshtër janë krejt çfarë janë. Pra, njerëzit e regjimit nuk janë vetëm njerëz të gënjyer që shpifin por edhe njerëz të shpifur që gënjejnë. E, megjithatë, ne nuk i urrejmë ata personalisht. Ne e urrejmë politikën e tyre që ata i shërbejnë: politikën e negociatave të vazhdueshme me Serbinë që e ka ndërprerë shtetndërtimin e Kosovës, dhe, politikën e privatizimit të egër që e ka pamundësuar zhvillimin ekonomik.

VETËVENDOSJE! duhet të bëjë së paku një komunikatë në ditë por edhe një aksion në javë. Aksioni sqaron sepse vendos në kontrast atë që kemi me atë që duam.

Informacioni për aktivitetet duhet përsëritur. Kur qytetarët e dëgjojnë një herë një njoftim ai përjetohet si informacion për spektatorin. Kur e dëgjojnë disa herë, atëherë ai bëhet thirrje për pjesëmarrje. Por, ballafaqimi sjell edhe informacionin e jo vetëm rezistencën. Ballafaqimi nuk lajmëron vetëm veteveten por edhe shkaqet e ndodhisë.

Nga modeli i Lennart Parknäs për fazat drejt aksionit mësojmë se: Alarmi është informatë alarmuese. Zakonisht njerëzit janë më të informuar për gjërat e tmerrshme sesa që neve na e merr mendja. Dhe, bombardimi me fakte shkakton pasivitet. Më tutje, gjatë dialogut me qytetarët, komunikimi nuk duhet të jetë i dominuar prej fakteve por prej përvojave dhe emocioneve që bëjnë krijimin e Ne-ndjenjës. Nuk duhet folur se si duhet të ndjehemi të ndërlidhur por duhet bërë diçka që i bën pjesëmarrësit të ndjehen të ndërlidhur. Duhet t'i dallojmë njerëzit nga idetë, duke respektuar njerëzit por duke i vënë në pyetje idetë e tyre. Heshtja është helm psikologjik (për ambientin).

Beteja është organizim dhe veprim i pandërprerë. Vetëm dy mënyra s'mund t'i përdorim më shumë sesa një herë në betejat tona: daljen nga Kuvendi dhe shatorrat te qeveria.

Mobilizimi është motivim

Popullit mund t'i ndihmohet vërtet vetëm nëse ke vendosur që atij të mos i hidhërohesh asnjëherë. Nëse besimi në popull dhe në energjitë e tij nuk e ka karakterin e aksiomës, atëherë s'ka revolucion. Përgjegjësia dhe fajësia duhet të kërkohen te sistemi politik dhe ekonomik si dhe te individit, por jo te populli.

Motivimi ynë buron nga bindja jonë për të vërtetën parimore të vlerave tona dhe dobinë e përgjithshme të qëllimeve tona. Motivimi për punë dhe aktivitet është çështje prioritare në organizatë. Pa motivim dhe inspirim të anëtarësisë nuk ka zgjerim të saj. Motivimi vie nga thellësia e bindjeve (jo thjesht nga nevojat) kurse inspirimi nga kreativiteti i udhëheqjes (jo thjesht nga detyrat).

Rezultati në punë e aktivitet është funksion i aftësisë dhe motivimit të aktivistit në varësi nga rrethana: $\text{Rezultati} = f(\text{Aftësia} \times \text{Motivimi}) / \text{Rrethana}$

Duhet ta shpjegojmë dhe përshkruajmë sesa të rëndësishme janë qëllimet tona dhe si ndërlihet arritja e objektivave të caktuara. Motivimi i (aktivistëve, anëtarëve dhe) qytetarëve varet edhe nga gjasat subjektive që ata ia përshkruajnë përpyekjeve të shtuara drejt performancës më të mirë, pastaj lidhjen që ata e perceptojnë midis performancës dhe një rezultati si dhe vlerën që ia japin atij rezultati.

Shumica dërrmuese e njerëzve, rreth 75% sipas disa studimeve, besojnë që motivimi kryesor për punë për njerëzit e tjerë është rroga, mirëpo ata përgjithësisht nuk e mendojnë këtë për veten e tyre: rrogën e kanë në vendin e tretë, të paraprirë prej kënaqësisë dhe përmbushjes që vjen nga punët ekzaltuese dhe sfiduese – pra, jo nga shpërblimet e jashtme, por nga ato të brendshme.

Politika e vërtetë nuk duhet të fillojë me ofertë për zgjidhje por me kritikë, pra, para se ta prezantojë alternativën e saj ajo duhet t'i kritikojë ofertat e rrejshme. Populli është rezistencë dhe intervenim. Njerëzit janë kritikë. Kundërshtimi i padrejtësisë është motivim.

Megjithkëtë, Lëvizja VETËVENDOSJE! nuk duhet të ndalet me kaq, ajo nuk duhet të bëjë vetëm aksione kundërshtuese ndaj regjimit dhe të kryejë punë për qytetarët vetëm aty ku e ka qeverisjen. Edhe si opozitë qendrore apo lokale, në gjithë vendin ose nëpër komuna, VETËVENDOSJE! duhet të bëjë punë vullnetare, publike e sociale, për qytetarët. Asisoj, me vepra konkrete lidhemi me popullsinë më shumë, i mobilizojmë ata për diçka shumë të prekshme (psh. pastrimi i lagjes) dhe fitojmë mbështetjen e tyre.

Nuk ka organizatë pa planifikim ditor, javor, mujor, stinor, vjetor, trevjeçar dhe pa planifikim konkret në të gjitha nivelet. Planifikimi kërkon imagjinatë të përcaktimit të objektivave, të përzgjedhjes së hapave dhe të përfytyrimit të arritjeve. Planifikimi është faktor mobilizues.

Vendimmarrja grupore ka përparësi dijen më të gjerë, legjitimitetin më të madh dhe kohezionin e shtuar, por ajo shpenzon më shumë kohë, bën kompromise të parakohshme dhe i bën më dembelë anëtarët.

Përvoja është mësim. Nëse përvoja nuk është mësim atëherë nuk kemi as histori dhe as ardhmëri. Mësimi duhet të jetë i qartë. Mësimi i paqartë nuk është mësim.

Njerëzit në përgjithësi, e rrjedhimisht edhe aktivistët, kanë nevoja ekzistenciale e të sigurisë, shoqërore e të përkatësisë, dhe të pranimit publik dhe ngritjes personale. Këto

duhet të kuptohen por jo edhe të mirëkuptohen së tepërmi. Aktivistët e Lëvizjes kapitalin e tyre njerëzor e vënë në shërbim të arritjes së qëllimeve të organizatës.

Lëvizja duhet t'i ndihmojë të varfërit që të mos ndjehen të turpëruar për varfërinë e tyre por atë turp ta kalojnë në zemërim kundër atyre që i varfëruan ata. Shumë pështymë gëlltisnin shqiptarët. Andaj janë aq të etur shqiptarët e varfër, kjo shumicë dërrmuese e popullit tonë. Të pasurit shfaqen shpesh në televizor si individë e si personalitete. Të varfërit shfaqen rrallë në televizor si turma ose si numra statistikash. Të varfërit e kanë rubrikën televizive "Hajt pak!", ndërkaq të pasurit e kanë rubrikën televizive "Hajt shumë!". Aktivistët e klasës së mesme duhet të kenë sa më shumë shoqe e shokë që u përkasin shtresave të varfëra. Varfëria e zvogëlon mobilitetin e njerëzve. Lëvizja duhet ta rrisë mobilitetin e tyre. Shoqëria është shoqërimi i të varfërve kundër pushtetit.

Ndëshkimi në organizatë duhet të jetë ndëshkim i veprimit a mosveprimit të caktuar apo i sjelljes së caktuar, më parë sesa i aktivistit të caktuar. Shkeljet mund të jenë gabime të paqëllimshme ose të bëra nga qëllimi i keq. Aktivistëve që bëjnë shkelje, varësisht nga shkalla dhe natyra e shkeljes, u jipet vëretje individuale joformale, qortim zyrtar publik, pezullim i anëtarësisë e deri te përjashtimi nga organizata. Ndëshkimi duhet të jetë objektiv, jopersonal, i shpejtë dhe pasi që është ofruar mundësia të dëgjohet arsyetimi i aktivistit që ka bërë shkelje.

Njerëzit nuk përtojnë të rrinë. Kosova është shumë më tepër vend i pronarëve (sado të vegjël që janë ata) sesa i punëtorëve (përfshirë këtu edhe ata joformalë). Ata të cilët në Lëvizjen VETËVENDOSJE! janë më shumë analistë sesa aktivistë, ankohen. Kur aktivistët bëhen më shumë analista sesa aktivista, kemi të bëjmë me lodhje ose devijim ose të dyja këto ngapak.

Pakica që mbivotohet në cilindo organ a forum të Lëvizjes nuk bën ta braktisë organizatën. Ajo mund të ketë pasur të drejtë. Kjo merret vesh më vonë dhe pakica duhet të jetë aty që të forcohet organizata. Megjithatë, daljet e aktivistëve nga Lëvizja VETËVENDOSJE! nuk është se e dobësojnë organizatën tonë. Ajo sërish forcohet meqenëse ata që dalin, me vetë faktin që dalin kanë qenë duke e dobësuar organizatën, ose me pasivitet ose me veprime të kundërta me parimet, konceptin a strategjinë tonë. Për më tepër, nuk e kemi asnjë shembull të asnjë ish aktivisti i cili pasi që doli nga Lëvizja i dha goditje edhe më të madhe regjimit dhe padrejtësisë. Mirëpo, lajmi për daljen e tyre mund të ketë ndalur anëtarësime të reja duke i bërë njerëzit më hezitues. Në Lëvizje dorëheqja është më parë egoizëm, sepse shkarkimi më parë është zgjidhja.

Populli nuk të do nëse nuk e don. Populli nuk të braktis, pa e braktisur ti njëherë atë. Neve populli na ka ndihmuar shumë jo vetëm duke marrë pjesë aktivisht në protesta: prej mikpritjes nëpër shtëpitë e tyre për tubimet që i zhvillonim dhe qiratë falas për zyrrat tona, e deri te votat në zgjedhje e qepët që na i hedhnin nga ballkonet në demonstrata.

Komunikimi është organizim

Me politikanët në institucione nuk flet dot për politikë, por vetëm për biznes. Duhet të shkosh te populli që të flasësh për politikën. Në përgjithësi, në Kosovë, populli flet për politikën shumë më tepër sesa politikanët të cilët zakonisht flasin për biznese(t). Politikanët në Kosovë flasin politikisht por jo për politikën, por për biznese. Populli flet jopolitikisht por për politikën. Politikanët e kanë politikën mjet e jo temë. Populli e ka politikën temë e jo mjet/mënyrë.

VETËVENDOSJE! s' duhet shumë të flasë për vete, por për popullin dhe shoqërinë. Ne duhet të kemi marrëdhënie të ndërmjetësuar me veten dhe direkte me popullin dhe shoqërinë. Jo çdo qytetar është aktivist, por çdo aktivist është qytetar. Sa më shumë që aktivisti është qytetar, aq më shumë qytetarë do të bëhen aktivistë. Lëvizja është një bashkëpunim i përditshëm i aktivistëve ndërmjet vete dhe me qytetarët për ta (arritur këtë te qytetarët me njëri-tjetrin. Nuk mund të udhëheqim dhe nuk duhet të udhëheqim nëse edhe nuk bashkojmë.

Lëvizja **VETËVENDOSJE!** duhet të jetë faktor unifikues i popullit, duhet të jetë ndihmuese për unitetin në popull, për dallim nga partitë politike të cilat kanë pasur shumë më tepër rol përçarës te populli.

Lëvizja duhet të jetë pranë popullit, shumë afër popullit, por, megjithatë, jo tepër afër tij. "Jeto në shekullin tënd, por mos ji krijesa e tij, ndihmoji bashkëkohësit e tu, por vetëm për atë që kanë nevojë, jo për atë që lavdërojnë." - Friedrich Schiller

VETËVENDOSJE! ka për detyrë që këtë shumicë të popullsisë që është e pakënaqur ta bëjë të vetëdijshme për veten e saj. Shumica është shumicë duke qenë e vetëdijshme për këtë. Pa këtë vetëdije s'ka ndryshim dhe asgjë si organizimi nuk e mundëson këtë vetëdije.

Puna politike informuese bëhet publikisht, individualisht, kolektivisht dhe masivisht, me popullin, qytetarët, si tërësi dhe si shumësi klasash, shtresash, profesionesh e grupesh interesi. Patjetër duhet t'i rrisim shpenzimet për informimin e popullit. Sot ne duhet më parë t'i informojmë njerëzit sesa t'i bindim ata.

Aktivistët e Lëvizjes duhet të jenë më të rreptë me njëri-tjetrin e më të dashur me popullin. Nëse i dëgjojmë qytetarët me kujdes edhe ata do të na dëgjojnë neve me më shumë vëmendje. Nga takimet dhe tubimet me qytetarë duhen mbajtur shënime organizative, si në aspektin teknik mbi pjesëmarrjen dhe temat e diskutuara, po ashtu edhe në atë përmbajtësor mbi tiparet sociale dhe veçoritë psikologjike të pjesëmarrësve. Duhet të mësojmë sa më shumë për përvojat lokale dhe konkrete të njerëzve tonë, për rutinat ditore të punës e ndejës së tyre.

Në secilin tubim duhet t'i jipet prioritet llojit të dëgjuesve nga populli e jo folësit të Lëvizjes. Varësisht se a u flasim studentëve, bujqve, minatorëve, punëtorëve të administratës, rinisë shkollore, fshatarëve të varfër etj. duhet t'i përshtasim fjalimet, fjalitë dhe fjalët tona. Përveç se duhet të jemi të qartë në shpjegime e përshkrime në

mënyrë që të na kuptojnë ne duhet edhe të përsërisim çështjet kryesore në mënyrë që ato t'i mbajnë mend qytetarët të cilëve ju drejtohem.

Secili aktivist e anëtar i VETËVENDOSJE!-s do të duhej ta bënte këtë: tri pasdite në javë, pas punës apo pas shkollës a studimit, të takohej me 4 a 5 qytetarë të tjerë, të flasë me ta për hallet e tyre, dhe t'i transmetojë këto probleme në Lëvizje. Secili prej nesh do të duhet të jetë më i ndjeshëm ndaj atyre halleve, sado të vogla e personale qofshin ato. Duke filluar nga kjo punë e secilit aktivist, pra një punë individuale, si ajo e milingonës apo bletës, ne do të arrijmë ta rrisim organizatën, dhe do të jemi në gjendje ta organizojmë zemërimin në rritje të popullit të varfëruar. Nëse ne nuk e bëjmë këtë, atëherë ajo zemëratë popullore do të përfundojë e gjitha në përpjekje për emigracion, në kriminalitet ordiner apo në ekstremizëm fetar.

Thashethëmat janë burim (dez)informacioni. Nuk bën ta nënçmojmë fuqinë e thashethëmës. Ajo zhvillohet shumë në një popullsi sikurse kjo e jona në të cilën analfabetizmi funksional (ku qytetarët i dinë gërmat por bëjnë shumë gabime në drejtshkrim e gramatikë) ka përfshirë afër 40% të popullsisë. Qartësia dhe thjeshtësia janë të domosdoshme për të luftuar moskuptimet e keqkuptimet. Kur gënjehet aq shumë zyrtarisht në institucione dhe medie publike, nuk është e befasishme pse njerëzit besojnë më shumë thashethëmat. Qëndrime të caktuara tonat në mjedise e kohë të posaçme duhet të përhapen pikërisht ashtu: pra, si thashethëma.

Në tubime e tribuna duhet të flasin shumë më tepër gratë dhe rinia. Patriarkalizmi i ashpër dhe kapitalizmi i egër janë rrethanë sulmuese dhe mendësi rrënuese për aktivizimin socio-politik të grave dhe vajzave. Dobësimi i shtetit e godet më shumë gruan se burrin në familje dhe jashtë saj. Prandaj, neoliberalizmi i kontribuon patriarkalizmit dhe e rrit varësinë e gruas nga burri.

Në masën në të cilën diskutojnë më radikalisht e me më shumë pasion e zell qytetarët sesa panelistët nga Lëvizja VETËVENDOSJE!, aq më e mirë dhe mobilizuese mbetet shija në fund kur të mbarojë tubimi a tribuna.

Gjithnjë e më pak ka debat në Kosovë. Sepse nuk ka ballafaqim argumentesh, faktesh e arsyetimesh. Ka veçse propagandë si reklamim mallrash, ku malli është një qëndrim i caktuar interesi. Propaganda konsiston te legjitimimi përmes përdorimit. Krahasuar me okupimin nga shekulli i kaluar, kemi kaluar nga mosinformimi te keqinformimi, nga terri informativ te mjegulla informative. Në terrin informativ e din që nuk po sheh, pa e parë këtë. Në mjegullën informative e sheh që nuk po sheh, por pa e ditur këtë.

Mjegulla i pasivizon njerëzit. Ata qëndrojnë brenda, të mbyllur, sepse jashtë ka mjegull. Kurrë më shumë medie s'kemi pasur. Kurrë më pak lajme s'kemi pasur. Kurrë më shumë mjegull s'kemi pasur. Dendësia e komunikimit të drejtpërdrejtë të aktivistëve me qytetarët kurrë s'ka qenë më e rëndësishme. Pra, jo vetëm Facebook, por sidomos Face-to-Face. Dhe, doemos e urgjentisht një portal informues i VETËVENDOSJE!-s për qytetarët.

Duhet sqaruar përcaktimet tona edhe në formë të parullave binare. Psh.:

Lëvizja VETËVENDOSJE! është:
Lëvizje PËR Zhvillim; Lëvizje KUNDËR Korrupsionit.
Lëvizje PËR Barazi; Lëvizje KUNDËR Privilegjeve.
Lëvizje PËR Prodhim Vendës; Lëvizje KUNDËR Varfërisë.
Lëvizje PËR Bashkim me Shqipërinë; Lëvizje KUNDËR Serbisë.
Lëvizje PËR Pakicat; Lëvizje KUNDËR Diskriminimit.
Lëvizje PËR Drejtësi; Lëvizje KUNDËR Kriminimit.
Lëvizje PËR Solidaritet; Lëvizje KUNDËR Përçarjes.
Lëvizje PËR Punësim; Lëvizje KUNDËR Migrimit.
Lëvizje PËR Paqe; Lëvizje KUNDËR Luftës.

Si për ata që tashmë janë anëtarësuar, po ashtu edhe për ata që duam t'i anëtarësojmë, nevojitet të kemi (pra, nga dy) strategji përkatëse për këto kategori shoqërore që përbëjnë bartësit kryesorë të ndryshimeve:

- 1) Gratë;
- 2) Rinia (këtu veçantë për 16, 17 e 18 vjeçarët);
- 3) Të varfërit;
- 4) Prodhuesit vendës;
- 5) Mërgata.

Rol të veçantë këtu kanë Sekretariati për Marrëdhënie me Jashtë (SMJ) dhe Sekretariati për Medie dhe Komunikim (SMK).

Organizata i përpilon parullat e javës dhe parullat e muajit. Duhet të ecim shpejt, sepse ne themi teori e romane për regjimin kurse njerëzit e tij shpifin me parulla për neve. "Organizata politike është vektor i parullave të fuqishme." ("Political organization is vector of powerful slogans.") – Alain Badiou

Organizata është përgjithësisht komunikim dhe logjistikë. Duhet ta kemi organizimin e fuqishëm në Lëvizjen tonë, sepse përndryshe humbim, por, megjithëkëtë, nuk duhet të fitojmë për shkak të organizimit të fuqishëm. Fitorja duhet të jetë fitore e idesë sonë, e konceptit tonë.

Aktivistët e VETËVENDOSJE!-s nuk duhet të marrin pjesë vetëm në emisionet televizive qendrore dhe politike. Sa më shpesh duhet të jemi të pranishëm me shpjegimet e idetë tona edhe në televizionet lokale si dhe në emisionet e ndryshme kulturore, shoqërore e argëtuese. Emisionet politike i shikojnë zakonisht ata që tashmë janë të pozicionuar politikisht duke pasur interesa të caktuara dhe aty mund të ketë fare pak lëvizje.

Ne e kemi fituar qeverisjen në Prishtinë edhe pse kemi folur përgjithësisht vetëm për qytetarin e Prishtinës, me gjuhën e mënyrën e tij. Duhet ta kemi parasysh gjithë Kosovën, gjithnjë e më shumë. Ne duam të kuptohemi, ne duam të na kuptojnë, prandaj, duhet t'i kuptojmë njerëzit që duan të na kuptojnë. Duhet të komunikojmë aktivisht me qytetarët. Të jemi komuni-aktiv.

Në biseda me qytetarët ata duhet t'i përballim me paradoksin e ankesave radikale që jo pak prej tyre i kanë për gjendjen e mjerueshme dhe të kërkesave të tyre për ndryshime të

buta e të kollajshme. Duhet përkujtuar VLAN-i dhe viti 2014, kur ne e kishim qeverinë në dorë si shumicë parlamentare me 63 deputetë, por ja që s'na e lejuan kapësit e shtetit! Madje, qytetarët duhet që ngapak edhe t'i qortojmë me dashuri. Psh. kur na ankohen për mungesë shprese duhet t'i pyesim se si i kanë punët me guxim!

Në diskutime e debate me njerëzit e regjimit, publikisht apo jo, aktivistët e Lëvizjes duhet që ta hedhin poshtë argumentin kryesor të regjimit e vetëm mandej të gjejmë gabime ose kundërthënie në atë argument, kurse rrallë ta kritikojmë tonin apo stilin e atij argumenti, ndërkaq pothuajse asnjëherë të mos sulmojnë karakteristikat apo personalitetin e argumentuesit nga regjimi.

Ka njerëz që nga mjerimi që i ka pllakosur nuk mund të bëjnë dallime midis politikanëve. Mirëpo, ka edhe jo pak të atillë që nuk duan të bëjnë dallime nga mendjemadhësia e tyre. Ata duan të fusin gjithçka në një thes në mënyrë që ta pamundësojnë moralin dhe të menduarit. Të bëhet e pamundur ndarja dhe shquarja e gjërave, ngjarjeve, qëndrimeve e botëkuptimeve. Neve me llupë na i kërkojnë njollat kurse para të zezës së regjimit i mbyllin sytë. Nganjëherë nevojitet një shkundje nga gjendja e tillë, porsi ujë i gotës që i hedhet fytyrës njeriut të zalisur. Gjithmonë ka njerëz që nuk dinë, por gjithmonë ka edhe aso që nuk duan t'ia dinë.

Njerëzit në Kosovë dinë të bëjnë bukur shumë akuza ndaj Lëvizjes sonë. Kjo nuk vjen vetëm prej faktit se duhet ta arsyetojnë mosangazhimin, por edhe prej një lloj edukimi të gjatë, masiv, të vazhdueshëm, mediatik e qeveritar të popullsisë kundër VETËVENDOSJE!-s. Komunikimi i vazhdueshëm me qytetarët është e vetmja përgjigje.

Komunikimi i brendshëm në Lëvizje me anëtarët e saj është jo më pak i rëndësishëm sesa ai i jashtëmi me qytetarët. SMK, në bashkëpunim me Koordinatorin për Qendrat, në mediet sociale duhet të ndërtojë shtigje e forume të mbyllura të komunikimit e informimit për aktivistët tonë sipas përgjegjësive të tyre dhe temave tona.

Komunikimi mund të jetë nga lart-poshtë dhe nga poshtë-lart. Një pjesë e tij i dendur ku shumë anëtarë komunikojnë me shumë anëtarë dhe një pjesë i rrallë ku shumë anëtarë komunikojnë me disa anëtarë. Diku ai duhet të jetë i centralizuar e diku i decentralizuar. Komunikimi bën shpërndarjen e informatave duke ndërtuar kuptimin e përbashkët për situatat, ngjarjet dhe objektivat aktuale.

Problemet në komunikimin midis aktivistëve duhet t'i shqyrtojë Sekretariati i Përgjithshëm. Ato shpesh janë pasojë e karaktereve të ndryshme që reflektohen te (mos)gatishmëria për mospajtim, sedra e lënduar, koha e nevojshme për besueshmëri, përkufizimi i (pa)qartë i argumenteve etj.

Në diskutimet përgjatë punës ekipore rol destruktiv luajnë agresori (që i sulmon të tjerët), bllokuesi (që pa nevojë kundërshton ekipin), dominuesi (që me manipulim synon autoritet), evituesi (që përqendrohet në ndjenjat dhe mendimet vetjake të cilat nuk janë të lidhura me qëllimet a objektivat e grupit), panikuesi (që pa nevojë shprehë pasiguri) dhe showman-i (që pa nevojë thërret për vëmendje te vetja e tij). (Sipas K.D. Benne dhe P.Sheets)

Pas mbledhjeve të Kryesisë ose Këshillit të Përgjithshëm të VETËVENDOSJE!-s, pas çdo konference për shtyp, fjalimi, debati televiziv a parlamentar, prononcimi publik, të aktivistëve të Lëvizjes sonë, duhet nxjerrur thelbi në formë titulli dhe fjalive goditëse të cilat lexohen, diskutohen e mësohen në çdo mbledhje të Grupit Punues në nivel Qendre e Pike e mandej edhe me qytetarët në takime e tubime. Aktivistët nuk i konsumojnë tekstet e Lëvizjes por i përkthejnë ato për anëtarët dhe qytetarët. Organizata përkthen shqip-shqip. Ajo i thjeshton dhe i përmbledh qëndrimet e kryesisë, fjalimet e deputetëve, studimet e komiteteve, shkrimet dhe intervistat e aktivistëve për anëtarësinë e gjerë dhe masat e popullit. SMK e përpilon çdo javë një tekst që fillon me: “Aktivistët e Lëvizjes VETËVENDOSJE! këtë javë thanë: ...”.

Diskutimet e brendshme në Lëvizje duhet të jenë sa më të shpeshta. Heshtja midis aktivistëve tregon ose konformizmin e tyre që i bën ata robotë ndaj udhëheqjes, ose pakënaqësinë e ndrydhur në rritje që shpërthen më vonë. Ne duhet të gabojmë sa më shumë me njëri-tjetrin që të gabojmë sa më pak me qytetarët e kundër regjimit. Nuk ka aspak rëndësi nëse ndonjëherë themi diçka të pamençur ose të pasaktë duke folur e diskutuar. Dialogu e komunikimi i brendshëm bëhet ngritje e dobi për të gjithë e secilin.

Organizata i lavdëron dhe inkurajon protestuesit në mesin e qytetarëve. Sipas një studimi, kur pyeten nëse kanë miq të vërtetë, njerëzit që marrin pjesë në protesta e demonstrata përgjigjen shumë më tepër pozitivisht sesa ata që nuk marrin pjesë në protesta e demonstrata. Lëvizja duhet ta bëjë të qartë se njerëzve që vijnë u ofron shoqëri shtesë çfarë nuk kanë pasur më herët.

Me anëtarët e VETËVENDOSJE!-s duhet të takohemi jo vetëm në aktivitetet tona politike por edhe në jetën e tyre shoqërore e kulturore, si individualisht po ashtu edhe në grupe. Organizata mban ndeja me aktivistë dhe me miq e simpatizantë të Lëvizjes një herë në muaj.

“Ne besojmë se mundet dhe duhet ndryshe...” Kjo duhet të jetë qasja e ligjërit tonë në komunikim. Nuk ndodh angazhimi njerëzor pse aty është mundësia, por pse ajo imagjinohet.

Aktivizmi është kulturë

Shpresën që ua japim qytetarëve duhet ta lidhim me aktivizimin e tyre. Jo shpresë që i lë ata si spektatorë. Pasiviteti sjell sëmundje. Si në jetën shëndetësore të individit po ashtu edhe në atë politike të shoqërisë. Utopistët nuk duhet t’i kritikojmë për utopitë e tyre, por për pasivitetin e tyre të cilin e justifikojnë me utopitë e tyre.

Njerëzit në Kosovë janë të pakënaqur me realitetin por vetvetiu s’angazhohen aq për ta ndryshuar atë. Për ta ndryshuar realitetin duhet ta keshë një ëndërr. E, siç thotë Jacques Lacani, ëndrrat janë më të papërbalueshme sesa realiteti. Nuk janë ëndrrat zëvendësim për realitetin. Kush s’i duron ëndrrat, e pranon realitetin.

Aktivistët nuk guxojnë të shpenzojnë më shumë kohë me njerëzit e regjimit sesa me njëri-tjetrin, dhe, nuk guxojnë të shpenzojnë më shumë kohë me njëri-tjetrin sesa me popullin. Ne duhet të merremi shumë më tepër ME qytetarët e paorganizuar sesa KUNDËR njerëzve të regjimit. Nga përvoja e dimë se kur dalin me mijëra protestues në protestat e VETËVENDOSJE!-s na thonë që kjo s'është gjë meqenëse Kosova i ka afër 2 milionë banorë! Mirëpo, ne s'kemi pse vendosemi përkundraill popullsisë. Ne jemi kundër regjimit, i cili me njerëzit e vet nuk përbën as disa mijëra veta sa ishim ne në protestë.

Te dilema mbi ndërmarrjen e aktiviteteve të caktuara, sipas Prof. Gerd Gigerenzer janë dy qasje: Kultura pozitive e gabimit (Po, mirëpo...) dhe Kultura negative e gabimit (Jo, sepse...). E para, e shikon rrezikun pozitivisht, pra si shansë, dhe ndërmerr të gjitha masat e kujdesit për vështirësitë dhe kurthet përpara. Gabime do të bëjmë sepse punojmë. Gabimet duhet t'i diskutojmë hapur e t'i identifikojmë. Dhe, duhet të kujdesemi që të mos i përsërisim ato. Përgjigja është: PO, por... E dyta, e shikon rrezikun negativisht, dhe përfundon duke i gjetur të gjitha argumentet e arsytimet pse nuk bën t'i hyhet atij. Kjo është qasja se ne nuk bëjmë gabime. Rrjedhimisht, kur i bëjmë gabimet ne nuk i pranojmë ato. E nëse nuk mund të mos i pranojmë atëherë fajësojmë ndonjë emër të përveçëm. Përgjigja është: JO, sepse ...

Aktivistët e Lëvizjes VETËVENDOSJE! duhet të bëhen gjithnjë e më të vlefshëm dhe gjithnjë e më të parëndësishëm, në kuptimin që gjithnjë e më kollaj të zëvendësueshëm. Aktivizmin nuk duhet zëvendësuar me aktivistizëm.

Aktivistët vazhdimisht bëjnë gjëra të guximshme sepse ata nuk evitojnë ballafaqimin. Le t'i kemi aktivistët njerëz të vullnetit. Le t'i kemi simpatizantët dhe gjithë popullsinë ata që mund të kalkulojnë racionalisht. Ide, vullnet, punë, përkushtim, disiplinë, ideal, besnikëri. Aktivizmi është edhe identitet. Aktivisti është aktivist i organizatës. Aktivisti është militant. “Një organizatë qëndron në pikëprerjen midis një Ideje dhe një ngjarjeje. Sidoqoftë, kjo pikëprerje ekziston vetëm si proces, subjekti i menjëhershëm i të cilit është militanti politik”. (“An organization lies at the intersection between an Idea and an event. However, this intersection only exists as process, whose immediate subject is the political militant.”) – Alain Badiou

Në veçanti, disiplinën e aktivistëve dhe në aktivizëm duhet ta posedojë organizata e jo ta imponojë udhëheqja. Disiplina e organizatës është kombinim i dashurisë me rreptësinë pa admirime e privilegje.

Lëvizja duhet t'i udhëheqë njerëzit duke i bindur dhe duke dhënë shembuj. Brenda organizatës, udhëheqësi nuk është ai që duhet ta ndjekim, por ai që i shërben dhe i ndihmon më së shumti organizatës e grupit për t'i realizuar qëllimet.

Edhe udhëheqësi është aktivist. Udhëheqësi është udhëheqës i organizatës, jo i idesë. Ai udhëhiqet nga ideja që është e organizatës. Organizata prodhon aktivistë që udhëheqin, karakteristikat e të cilëve janë: motivimi i të tjerëve, integriteti personal, vetëbesimi, aftësia studiuuese dhe analitike, dija e përgjithshme dhe posaçërisht ajo e Programit Politik dhe Alternativës Qeverisëse të VETËVENDOSJE!-s, të qenit i hapur për përvoja të reja

dhe të qenit komunikativ me aktivistët dhe popullin. Jo vetëm udhëheqësit, por edhe idetë duhet që të bashkohen, e jo vetëm të udhëheqin. Idetë udhëheqëse që nuk bashkohen njëkohësisht, përfundojnë te udhëheqësit individualistë.

Nga aktivizmi nuk guxon të pasurohesh materialisht pavarësisht mundësive e shanseve. Përderisa je në politikë, nuk duhet të jesh më i pasur sesa kur nuk ishe në politikë. Pra, është e domosdoshme që pasuria e politikanëve të Lëvizjes të mos rritet me kalimin e kohës. Madje është e preferueshme që të bëhesh më i varfër duke qenë në politikë. Por, kurrsesi më i pasur.

Aktivisti është vlerë

Vlerat dhe qëllimet ta japin drejtimin. Vlerat pa qëllime janë të padobishme. Qëllimet pa vlera janë të pandershme.

Nuk ka kritikë pa vetëkritikë, sepse jemi bashkë. Meqë jemi bashkë, nuk ka të pafajshëm. Ndonëse jemi bashkë, nuk jemi njësoj të fajshëm. Përgjegjësitë e ndryshme (sipas llojit) janë mundësi të ndryshme (sipas shkallës) që tërheqin përgjegjësi të ndryshme (sipas mundësive). Përgjegjësia edhe duhet individualizuar sepse përgjegjësitë janë individualizuar.

Lëvdata e qortimi, kritika dhe vetëkritika duhet të jenë të vazhdueshme për aktivistët lidhur me punën që bëjnë. Kufijtë e njeriut janë kufijtë e vetëkritikës së tij. Duhet të ruhem nga vetëkritika e tepërt kolektive me pak vetëkritikë individuale. Nuk mund ta ndryshojmë aspak sistemin politik nëse nuk jemi të gatshëm të ndryshojmë shumëçka në jetën e secilit prej nesh.

Kritika për VETËVENDOSJE!-n apo cilindo organ ose aktivist të saj duhet të bëhet nga gjendja e një dashurie për Lëvizjen, një brengje për gjendjen e Lëvizjes sonë dhe përderisa duam të bëjmë ndryshime progresive. Nuancat e ndryshme të së majtës në mesin e aktivistëve të Lëvizjes sonë mbase do të vinin në shprehje në Evropën perëndimore, jo në Kosovën neolibérale ku VETËVENDOSJE! është i vetmi subjekt i majtë.

Nuk ka anëtarësim pa prodhim, sepse jemi Lëvizje. Prodhimi mund të jetë: shkrim, hulumentim, ide për aksion/aktivitet dhe/ose pjesëmarrje në të, anëtarësime të reja, donacion material apo financiar etj.

Aktivisti i VETËVENDOSJE!-s është:

- I organizuar dhe aktiv. Organizimi pa aktivitet bëhet burokraci. Aktiviteti pa organizim bëhet anarki.
- Krenar dhe modest. Krenaria pa modesti bëhet mendjemadhësi. Modestia pa krenari bëhet injorancë.
- I dashur dhe rigoroz. Rreptësia pa dashamirësi bëhet arrogancë. Dashamirësia pa rreptësi bëhet lazdrim.
- I vendosur dhe analitik. Nuk ka vlerësim e gjykim pa studim dhe analizë. Gjykimi pa studim është teke arbitrare. Studimi pa gjykim është pavendosmëri dërrmuese.

- I zemëruar dhe me shpresë. Zemërimi pa shpresë bëhet hakmarrje. Shpresa pa zemërim bëhet dëshprim.
- I mësuar dhe debatues. Mësimi pa debat bëhet vetëmbyllje. Debati pa mësim bëhet llafazani.
- Punëtor dhe i aksionit. Puna pa aksion të mërzit. Aksioni pa punë të bën dembel.

Të qenit radikal nuk do të thotë aspak joracionalitet. Të qenit radikal është e arsyeshme ashtu siç është e arsyeshme që të jeshë i drejtpërdrejtë dhe ta kërkosësh thelbin e problemit e jo pasojat e tij që pluskojnë në sipërfaqe. E, megjithëkëtë, aktivistët e Lëvizjes nuk janë radikalë (apo edhe agresivë) për nga karakteri por, më parë, për nga tema. Aktivistët kanë mendime të qarta dhe madje të prera për çështjet e temat por jo për njerëzit e qytetarët e veçantë.

Morali i aktivistit të Lëvizjes ndodhet në luftën e ndërgjegjshme kundër shtypjes e shfrytëzimit të popullit nga establishmenti. Aktivistët e Lëvizjes nuk përmbushen me atë çka marrin, por me atë çka bëjnë.

Nga bazat e fizikës dihen këto formula themelore: s (Rruga) = v (Shpejtësia) x t (Koha),

a (Nxitimi) = v/t ,

F (Forca) = m (Masa) x

a , P (Fuqia) = $m \times v$,

E (Energjia) = $1/2 \times m \times v^2$,

A (Puna) = $F \times s = P \times t$.

Forca varet nga masa, por varet edhe nga nxitimi (e shpejtësia). Për energjinë, shpejtësia është më e rëndësishme sesa masa. Kemi shumë aktivistë që kanë masë/peshë (formalisht dhe/ose joformalisht) por nuk kanë aq shpejtësi e nxitim. Pra, kemi shumë aktivistë që kanë masë, por janë të ngadalshëm. Me fjalë të tjera, kanë peshë por s'kanë energji. Fotoni, grimca elementare e dritës valore i cili e ka masën e qetësisë zero, paraqet aktivistin *par excellence* të Lëvizjes. Nuk bart poste dhe është bartës ndriçimi, nuk mund të vërehet vetë dhe mundëson të vërehet çdo gjë tjetër.

Skamja është realiteti

Brenda Kosovës ndodhet një botë e tretë e madhe. E zhytur në varfëri e mjerim. Kjo botë sa vie e rritet, me të njëjtin intensitet që fliten përrallat për integrimet evropiane. Njerëzit në Kosovë nuk kanë vend pune dhe të ardhura të mjaftueshme, nuk marrin shërbime publike të mirëfillta, arsim solid e kujdes shëndetësor, nuk kanë ushqim cilësor, veshmbathje adekuate, ngrohje të përhershme, energji elektrike të rregullt dhe furnizim me ujë të pandërprerë. Në Kosovë, njerëzit nuk kanë. Skamja është realiteti.

Për shtetin e Kosovës historikisht më së shumti janë sakrifikuar e kanë kontribuar të varfërit. Pas çlirimit, sërish sakrifikuan e kontribuan të varfërit më së shumti për këtë pavarësinë që u shpall nëntë vjet më vonë. Ndërkohë, po gatuhej karakteri neoliberal i shtetit. Çdo ditë bëhej e qartë se ky shtet i Kosovës do t'iu takonte të pasurve si vegël e tyre. Burokratët ndërkombëtarë kështu donin, dhe komandantët e luftës po nguteshin të

pasuroheshin. Pas shpalljes së pavarësisë, autostradat në Kosovë i kanë paguar më së shumti të varfërit (prej të cilëve kryesisht mbushet buxheti i shtetit) kurse i shfrytëzojnë më së shumti të pasurit (të cilët voziten me makina luksoze e të shpejta).

Njerëzit e varfër janë të varfër jo pse kështu ka thënë zoti apo pse kështu e ka kushtëzuar natyra. Njerëzit e varfër janë të varfër për shkak të disa njerëzve të tjerë që me pushtetin e tyre i varfërojnë të tjerët dhe e pasurojnë veten e tyre. Kështu, pakica ka shumë e shumica ka pak. Dikush në Kosovë nuk po ka as të drejta për mbijetesë e dikush ka edhe privilegje për luks. Dikujt nuk po i plotësohen as nevojat e dikujt po i plotësohen edhe dëshirat. Shteti është bërë nënë e dashur për të pasurit dhe njerëz e hidhur për të varfërit.

Kosova nuk është vend i varfër por populli i Kosovës është popull i varfër. Nuk i kemi qytetarët të varfër e të papunë kurse pushtetarët të pasur e të korruptuar pse jemi vend pa pasuri, popull pa histori e shoqëri pa kulturë, por pse dogma e neoliberalizmit është instaluar në shtet. Emigrimi masiv i tanishëm tregon se qytetarët e lirë të Kosovës po arratisen nga dogma e lirisë! Në vend se ta mbajmë pronësinë publike e shtetërore të ndërmarrjeve strategjike dhe ta ndërrojmë menaxhmentin e korruptuar, privatizimi në Kosovë e ka ndërruar pronarin dhe e ka mbajtur atë menaxhment!

Raporti i Bankës Botërore i para dy vitesh tha që 80% të popullsisë në Kosovë janë të varfër, jetojnë me më pak se 5\$ në ditë, pra më pak se 3,8 € në ditë (26,6 € në javë apo 114 € në muaj). Sistemi i shfrytëzon dyfish të varfërit: individualisht me kamata të larta të kredive dhe kolektivisht me tatim joprogresiv. Në bankat e Kosovës kamatat për kredi janë afër 14%, gjë që është 15 herë më e lartë sesa shkalla e interesit për depozitat, ndërsa kolaterali është sa katërfishi i vlerës së kredisë. Asetet e sektorit financiar janë 3/4 te bankat dhe 1/5 te fondet pensionale. 70% të aseteve bankare menaxhohen nga 3 bankat më të mëdha (nga 9 sosh gjithsej) dhe 90% e bankave janë në pronësi të huaj. Bankat në Kosovë mundësojnë që të pasurit të bëhen edhe më të pasur kurse të varfërit të varfërohen edhe më shumë. Për pesë vjet i bie ta paguash dyfishin e kredisë. Shkatërrim i planifikuar i klasës së mesme.

Deficiti tregtar i Kosovës është 35,1% të Bruto Produktit Vendor (BPV), pra më i madh se 1/3 e BPV. Me këso hapje të tregut tonë nuk i kemi nivelizuar punësimin e pagat me Bashkimin Evropian (BE) por vetëm çmimet. BPV për kokë banori në Kosovë është sa 1/9 e mesatares në BE apo sa te Britania e Madhe para 150 vjetëve. Buxheti i Kosovës është më i vogël sesa paratë që ndodhen jashtë vendit: 1,2 miliardë euro të Trustit Pensional dhe 600 milionë euro të Fondit të privatizimit. Në Kosovë janë investuar vetëm 2,5% të Fondit të Kursimeve Pensionale.

Me vetë faktin që në Kosovë kemi papunësinë prej 45% të popullsisë aktive dhe varfërinë prej 63% (45% të varfër dhe 18% në varfëri të thellë) i bie që në numra absolutë, në Kosovë kemi sa të varfër aq edhe të papunë, duke mos konsideruar natyrisht se bëhet fjalë për të njëjtit njerëz. Afër 70% të të papunëve janë të papunë afatgjatë dhe 57% të papunëve janë të pakualifikuar (Raporti i Progresit 2014). Andaj e kemi disi popullsinë të lodhur.

Të gjithë ata që e mbrojnë kapitalizmin për ta mbrojtur konkurrencën, duhet ta kenë parasysh që pa ndërhyrjen e shtetit nuk ka konkurrencë të garantuar. Thjesht, kapitalistët e fuqishëm merren vesh dhe kollaj sajojnë oligopole. Ata që thonë se shkaqet e mjerimit janë historike, natyrore ose kulturore, ata sugjerojnë se zgjidhja ndodhet te emigrimi ose neokolonizimi, e dihet se interes i kujt mund të jetë kjo.

Kot flitet për shanse të barabarta në Kosovë përderisa këto shanse nuk të nxjerrin dot nga varfëria. Psh. mund të thuhet që në një burg të sigurisë së lartë, të burgosurit i kanë shanset e barabarta të ikin, apo jo? Mirëpo, kjo gjë sigurisht se nuk thotë asgjë mbi vetë shanset për të ikur nga burgu. Shansi të dalësh nga varfëria është pothuajse kurrfare për qytetarin e Kosovës.

Varfëria bëhet degraduese totalisht kur psh. duhet të zgjedhësh nëse duhet t'i ushqesh fëmijët ose ta ngrohësh dhomën dhe ujin. Jeta e dinjitetshme nis atëherë kur nuk bën (këso) zgjedhje. Shqiptarët më së shumti shpenzojnë për ushqim. Kjo nuk do të thotë që ushqehen mirë. Përkundrazi, kjo do të thotë që ushqehen varfër dhe s'bëjnë jetë cilësore.

Shumë qytetarë të shtresës së ultë të klasës së mesme njëmend rrinë nëpër kafiteri, por ama jo pse kanë para por për shkak se s'kanë para për asgjë tjetër përveç ushqimit. Nuk shkojnë në teatër e kinema, nuk blejnë libra. E gjithë jeta shoqërore e publike zhvillohet në ato kafiteri.

Kriza e rëndë socio-ekonomike në Kosovë është krizë vetëm për njërin palë, për popullatën, për masat e gjera të popullsisë, për shumicën dërmuese të qytetarëve të Kosovës. Jo edhe për pushtetarët. Ata s'janë në krizë. Dhe, përderisa ushtrimi i pushtetit të tyre mbi shumicën nuk pëson (po ashtu) krizë, nuk do të ketë ndryshime sado që i dëshirojmë ato. Pushtetarët s'janë në krizë jo pse ata s'janë të varfër e të papunë si popullsia, por për shkak se ata s'kanë pengesa të pakalueshme në ushtrimin e pushtetit të tyre mbi popullsinë. Qeveria dhe kryesitë e partive më të mëdha, pronarët dhe kryeredaktorët e mediave kryesore, biznesmenët e mëdhenj, paraqesin klasën dominuese në Kosovë. Për votat e të varfërve kandidojnë të pasurit që të bëhen edhe më të pasur.

Multi-etniciteti, si doktrinë në themelet e shtetndërtimit në Kosovë, është menduar t'i mbrojë pakicat e tjera nga dominimi i shqiptarëve. Ndërkohë, pavarësia e Kosovës sabotohet nga Serbia së cilës i bëhen vazhdimisht koncesione në kurriz të shqiptarëve. Diversiteti si tolerancë ndaj dallimeve është afirmuar si i tillë ndaj dallimeve kulturore, etnike, fetare, racore. Mirëpo funksioni i tij kryesor është tolerimi i dallimeve klasore e rrjedhimisht normalizimi dhe natyralizimi i tyre. Pra, tolerimi i pabarazisë! Edhe reformat ekonomike nuk janë neutrale në kuptimin klasor. Duhet (para)shikuar kush, sa e si përfiton prej tyre. Ndarjes vertikale në shoqëri sipas profesioneve duhet t'ia shtojmë atë horizontale sipas klasave. Në Kosovë më i madh është diskriminimi mbi baza klasore, partiake, gjinore, moshore e të vendbanimit sesa mbi baza kombëtare/etnike.

Në shumicën e mediave kosovare varfëria rrëfëhet konkretisht në mënyrë që të mos shpjegohet ajo përgjithësisht. Që të mos bëhet pyetja se pse të varfërit janë të varfër. Sepse, kjo pyetje do të mund të shpinte në atë tjetrën: pse të pasurit janë të pasur, konkretisht dhe përgjithësisht?

Kur e trajton varfërinë pa i cenuar të pasurit atëherë përfundon në një situatë paradoksale, atë të lutjes për filantropi. Lëmosha nuk të nxjerr nga varfëria por ta konfirmon atë teksa të obligon të jeshë falenderues e mirënjohës për të.

Studime të ndryshme akademike dhe përvoja jonë jetësore na e dëshmojnë që sa më të pasur të jenë njerëzit aq më pak brengosen për miqtë e tyre dhe aq më shumë janë të obsesionuar me vetveten e tyre. Mund të thuhet që të varfërit e kanë të imponuar solidaritetin por kjo nuk paraqet kundërgargument. Përkundrazi.

Ata që janë të pasur a të suksesshëm, përgjithësisht, besojnë që kjo është për shkak se ata janë të veçantë (për të mirë) përkundër sistemit (i cili është aq larg nga të qenit i përsosur). Mirëpo, të varfërit a të pasuksesshmit sërish nuk duan t'i shohin si viktimë të po atij sistemi (aq të papërsosur), por sërish si njerëz të veçantë (për të keq).

Duke e konsideruar pabarazinë fakt të kryer dhe duke ia vënë barrën e argumentimit dhe arsytimit atyre që afirmojnë idealin dhe nevojën për barazi, shoqëria tashmë ndodhet e dominuar nga neoliberalizmi por edhe dëshmohet se te pabarazia si fakt i kryer s'ka asgjë të natyrshme dhe gjithçka është e imponuar. Pabarazia e theksuar në të ardhura dhe pasuri e ndan shoqërinë në ata që japin urdhëra dhe në ata që marrin urdhëra. Pa barazi humbet edhe liria.

Neoliberalët i gjykojnë të varfërit me moralin e të pasurve. Kjo tashmë është kontradiktore. Asistencën sociale e kundrojnë duke presupozuar e përshkruar lakminë e vetvetes së tyre.

Të varfërit paqësorë janë ideali i regjimit neoliberal. Paqja është mallkimi i të varfërve. Varfëria prodhon kulturë. Kulturë të mbijetesës. Për ta bërë të durueshme jetën e rëndë formësohen ceremoni e rituale që natyralizojnë e normalizojnë. Ndërkaq gjestet, sjelljet, shijet, shakatë komunikuese bëhen aq të rëndësishme saqë paraqesin urëzime të fuqishme të klasës duke i fshirë kufijtë midis klasave.

Shumë qytetarë ankohen pse nga komuna a rajoni i tyre s'ka deputetë ose ka pak deputetë. Përveçse është shumë më e rëndësishme se çfarë deputetësh janë sesa prej nga vijnë, thelbësore është se nga çfarë shtresash shoqërore vijnë deputetët – psh. të varfërit s'janë fare të përfaqësuar ndërkaq klasa e mesme është pak e përfaqësuar. Klasa shoqërore e jo komuna a rajoni janë thelbësore.

Shqiptarëve duke iu ardhur turp pse janë të varfër, kërkesat e tyre bëhet lutje dhe lypje për mëshirë. Atë që e fitojnë ata nuk e konsiderojnë që iu takon por se ndodhi një mrekulli, apo, së paku, që kanë pasur fat. Prandaj, shqiptarët gëzohen e kënaqen kollaj. Të arriturat i kanë spektakulare.

Njerëzit e varfër duhet të ndërgegjësohen për pafajsinë e tyre për gjendjen e tyre. Varfëria është padrejtësi. Shoqëria dhe pasuria e përbashkët nuk janë plaçkë për të cilën duhet të shtyhem me bërryla. Për shoqërinë duhet të kontribuojmë të gjithë, dhe pasuria duhet të shpërndahet.

Neve na nevojiten taborret në betejat politike në domenin klasor e kombëtar por jo në domenin fetar. Ata që duan taborre në domenin fetar, nuk i kontribuojnë as bashkimit kombëtar dhe as luftimit të shfrytëzimit ekonomik që po i bëhet vendit tonë.

Njerëzit e varfër nuk besojnë në demokraci edhe pse pikërisht ata janë shumica e popullsisë. Njerëzit e varfër besojnë në fuqi, në dhunë, me të kanë kryer punë ndonjëherë. Dhe, kur njeriu beson në fuqi, s'ë ka atë, e megjithatë nuk do t'i nënshtrohet një autoriteti, ai beson kollaj në zot mandej. Më tutje, fundamentalizmi fetar (dhe deri diku nacionalizmi) është shpërftyrim i luftës klasore në kushtet e mungesës së vetëdijes klasore.

Njerëzit frikësohen të mendojnë pse dhe si dikush u bë besimtar shumë i devotshëm i një feje. Nuk duan ta konsiderojnë se mos e kanë nga varfëria e papunësia, nga arsimi i dobët, nga dobësimi i identitetit kombëtar, nga nevoja për rregull, rend e diciplinë, nga partitë politike neoliberales që i bëjnë Biblën e Kuranin të duken programe socialiste, nga manipulimet që mundësohen nga mospasja e sovranitetit dhe kontrollit shtetëror etj. etj.

Klasa e mesme është e brengosur për korrupsionin kurse të varfërit për punësimin. Klasa e mesme është e preokupuar me shërbimet kurse klasa e varfër me të ardhurat. Për imazhin e Kosovës kurrë nuk e kemi dëgjuar duke folur ndonjë të varfër, por vetëm të pasurit ose shtresën e epërme të klasës së mesme. Kur thua se dikush i përket klasës së mesme ende s'dimë gjë – klasë e mesme me shikim kah të varfërit apo të pasurit? Kjo është çështja!

Kosova ka nevojë për siguri ekonomike për të gjithë e jo për siguri policore kundrejt të varfërve që 'po ia prishin imazhin'. Në këtë kuptim jo vetëm që duhet të kemi imazh demokratik, por edhe duhet ta demokratizojmë imazhin. Shteti i Kosovës nuk mbron gjë: as kulturën dhe as ekonominë e vendit. Prandaj, mbrojtja e njeriut është mbrojtje e njeriut të akulturuar e të varfër. Imazhi zyrtar është maskë publike.

Duhet të kemi mirëkuptim për njerëzit që janë të kushtëzuar nga rrethanat e vështira jetësore por edhe për ata që vuajnë pasojat e zgjedhjeve të gabuara në jetë. Ky mirëkuptim yni duhet të shprehet në politikat sociale (në program) dhe në ndarjet buxhetore (në qeverisje). Mirëqenia e përgjithshme në Kosovë nënkupton që s'duhet të ketë familje pa kulm mbi kokë dhe shtëpi pa dikë të punësuar. Ky është minimumi ynë që duhet shpallur botërisht e ditur paraprakisht.

Vendi i punës duhet të jetë një e drejtë në funksion të mirëqenies së qytetarit e jo armë në duart e pushtetit për t'i disiplinuar qytetarët. VETËVENDOSJE! është e përqendruar te progresi shoqëror e jo thjesht te sukcesi individual. Alternativa Qeverisëse është për demokratizim të ekonomisë dhe për sovranitet ekonomik.

Kur të pasurit i vjedhin të varfërit kjo quhet biznes, ndërkaq kur të varfërit kundërpërgjigjen kjo quhet dhunë. Kështu thoshte me të drejtë një parullë e protestave të punëtorëve në ShBA. Kriza në Kosovë do të shpërthejë. Si kriminalitet në masë, si

emigrim i dëshpërueshëm, si ekstremizëm fetar, si revolucion kundër regjimit. Si mund të mos jemi për këtë të fundit?!

Realiteti është më shumë se faktet objektive, sepse vullneti subjektiv njerëzor është përherë aty. Mirëpo, pa vullnetin për t'i njohur e studiuar faktet realisht nuk mund të kemi organizime politike dhe politika publike. Faktet e popullsisë së Kosovës janë fakte të skamjes. Lëvizja i ka njerëzit që s'kanë.

Fronti është nevojë

Anëtarësimet dhe aktivizimet në Lëvizje nuk do të jenë të përnjëhershme por me faza dhe të vazhdueshme. Dhe, kurrë nuk do të bëhen e nuk duhet të bëhen të gjithë qytetarët anëtarë të VETËVENDOSJE!-s. Fronti është shoqëror dhe ndërtimi i Frontit shoqëror është i nevojshëm.

Bashkëpunimi me organizata, shoqata e subjekte të tjera duhet të jetë për aktivitet e në aktivitet, më parë sesa strukturor a identitar. Nëpër beteja të përbashkëta ndërtohet bashkimi i vërtetë. Nëse shumë njerëz të mirë nuk punojnë më shumë sesa njerëzit e këqij (sado që të jenë ata), atëherë e keqja nuk ndalet. “Nëse nuk lëvizin ata që mund të ndihmojnë, atëherë le të ngritemi ne të tjerët.” (“Ako se ne miču oni koji mogu da pomognu, dignimo se mi ostali.”) – Miroslav Krleža

Edhe në paçin ngjashmëri të mëdha me PDK-në, partitë e opozitës nuk janë të barabarta me PDK-në: ato s'e kanë kapur shtetin. Policia, prokuroria, gjyqësia, RTK-ja, ndërmarrjet publike qendrore, bordet dhe menaxhmentet e 38 agjencive shtetërore janë të kapura nga PDK-ja dhe ShIK-u. Në zgjedhjet e fundit nuk ka fituar PDK e Thaçi por klientelizmi dhe kapja e shtetit.

Struktura është mjet për qëllimet e caktuara politike. Por, ajo mund të ketë efekte të tjera jashtë qëllimeve. Struktura është ekskluzive. Fryma është inkluzive. Frontin duhet parë si shans që strukturat e domosdoshme të Lëvizjes sonë i kompensojnë jo vetëm me frymën e Lëvizjes por edhe në frymë të frontit shoqëror. Organizimi edhe me të tjerët krijon vlerë të shtuar shoqërore.

Edhe nëse secili qytetar i Kosovës e do ndryshimin në Kosovë, por këtë e kanë disi porsì hobi, ndryshimi nuk do të ndodhë. Një masë kritike e tyre, etjen për ndryshim, duhet ta konsiderojnë jetike, jo si një hobi, por si çështje kryesore, si vend pune e ushtrimi profesional, si çështje vendimtare jetësore. Në mos për asgjë tjetër, së paku për shkak se nga ana tjetër janë njerëzit e regjimit që e kanë çështje jetike mosndryshimin.

Duke u dukur të mençur e të ditur, Lëvizja VETËVENDOSJE! ka krijuar përshtypje të gabueshme se ka mjaftueshëm kuadro. Mandej ka ekspertë të cilët për këtë arsye nuk na afrohen. Njëkohësisht, njerëzit e mençur e të mirë nuk vijnë kollaj në Lëvizjen tonë. Më shumë mendojnë për t'u anëtarësuar në VETËVENDOSJE! sesa kur vendosën për t'u martuar apo përzgjedhën fakultetin që studiojnë. Sadopak të mos pajtohen me ne

(konceptin, qëndrimet, metodat) kjo iu bëhet tepër shumë. Prandaj, afrimi i tyre me Lëvizjen është sukses më i madh seç mendohet.

Kultura është partikulare dhe kolektive. Kultura e veçantë, e caktuar, i referohet një bashkësie njerëzish të posaçëm, bashkarisht të ndarë. Prandaj, Kosova me kategorinë e saj themelore politike e institucionale (bashkësitë nacionale) është thelbësisht sistem politik kulturor që ia nënshtron ekonominë kulturës, që e ndan popullin e shoqërinë e qytetarët sipas kulturave. Më tutje, njerëzit besojnë që rajoni, qyteti, fshati i tyre është fort i veçantë dhe mbesin të izoluar. Mirëpo, përgjithësisht pasojat janë kulturore, ndërsa shkaqet janë socio-ekonomike. Lëvizja i lidh njerëzit. Njerëzit e lidhur me njëri-tjetrin zgjidhen prej regjimit. Lëvizja i bashkon njerëzit. Njerëzit e bashkuar me njëri-tjetrin ndahen prej regjimit.

Në protesta të VETËVENDOSJE!-s më dominuese se vetë tema apo kërkesa e protestës është fakti që protestën po e organizon VETËVENDOSJE!. Kjo vë nga identiteti i fuqishëm që ka Lëvizja jonë te figura imagjinative e qytetarëve. Një gjë e këtyllë i ka përparësitë për mobilizim të militantëve tonë por edhe dobësitë e veta për bashkëpunim me të tjerët. Nga bashkëpunimi me Lëvizjen tonë, shoqatat e vogla duhet ta ndërprerë se u forcuan ca. Interesat e të tjerëve duhet t'i trajtojmë hapur e sinqerisht.

Lëvizja politike është një infrastrukturë e hapur për ata që duan të lëvizin, që duan të angazhohen politikisht dhe që nuk e kuptojnë politikën thjesht si pozicionim në një krah, por si një angazhim të përditshëm i cili në një mënyrë ta merr krejt jetën. Ta merr jetën duke ta ndërprerë jetën, ose ta merr jetën për shkak se zgjatë gjatë gjithë jetës.

Edhe në vetë Lëvizjen tonë do të ketë kundërthënie dhe duhet të ketë kundërthënie. Sepse s'jemi parti në luftë por lëvizje e masave. Nuk duhet t'iu frikësohemi kundërthënies në frontin e përbashkët shoqëror.

Nga koha e VLAN-it janë nxjerrur dy mësimet fantastike: 1) Lëvizja VETËVENDOSJE! nuk është ekskluzive, ajo bashkëpunon me të tjerët, por shikojeni me kujdes se kush po e tradhëton VETËVENDOSJE!-n; 2) Në shtetin e kapur nuk mund të ketë zgjidhje vetëm institucionale, vetëm brenda institucioneve. Lenini e shpjegon mirë se si pararoja duhet të jetë propagandë e agitacion te masat, por pa përvojën politike të vetë këtyre masave, pa e përjetuar ato në kurrizin e vet shtypjen e "pushtetit më të ri përparimtar" nuk ka revolucion.

Në negociatën për koalicion me të tjerët por edhe në ato me kundërshtarët duhet ndarë idetë nga njerëzit dhe qëllimet nga parimet. Dhe, duhet ndjekur këto tri udhëzime: 1) Nuk ka kompromis në qendër (Gandhi); 2) Dihet shtegu i progresit pas kompromisit; 3) Kompromisi i bërë nuk tërheq kompromise të vazhdueshme të tjera.

Në vijim janë dhënë taktikat e negociimit me kundërshtarët, sipas K. W. Thomas, R. E Walton, R.B. McKersie:

Taktikat Shpërndarëse

- Bindeni tjetrit që prishja e negociatave do t'iu kushtojë atij.

- Bindeni tjetrin që ju ndiheni shumë të përkushtuar në arritjen e rezultatit të synuar.
- Parandalojeni tjetrin nga krijimi i një përkushtimi të fortë për një rezultat afër synimit të tij.
- Lejojeni tjetrin ta braktis pozicionin e tij pa humbje fytyre apo kostoje tjetër.
- Bindeni tjetrin që rezultati i juaj i synuar është i drejtë.
- Bindeni tjetrin që rezultati i tij i synuar është i padrejtë.
- Bindeni tjetrin që palë të treta të rëndësishme e favorizojnë rezultatin e juaj të synuar.
- Përdorni humor jo-armiqësor për të ndërtuar ndikim pozitiv.
- Hutojeni tjetrin për ta dobësuar aftësinë e tij për t'u koncentruar.

Taktikat Integruese

- Demonstrojani tjetrit që shqetësimet e tij janë të rëndësishme për ty.
- Demonstrojani tjetrit që rezultati i qëllimit tuaj është tepër i rëndësishëm për t'u komprometuar.
- Demonstrojani tjetrit që një rezultat fitore-fitore është një mundësi.
- Demonstrojeni që ju jeni të ndryshueshëm sa u përket disa zgjidhjeve.
- Insistoni në kritere të drejta për të vendosur mes zgjidhjeve të mundshme.
- Bëni normat bashkëpunuese të spikatura.
- Minimizoni përdorimin e sjelljeve apo taktikave që do të shkaktonin emocione negative.
- Siguroni një atmosferë emocionalisht mbështetëse.
- Mbrojeni tjetrin nga hutimet emocionale.

Taktikat e Strukturimit të Sjelljes

- Përdorni gjuhë të ngjashme me atë të palës tjetër.
- Ndajeni veten nga të tjerët që nuk janë të pëlqyer nga oponenti.
- Lidhni veten me të tjerë të pëlqyer nga oponenti.
- Shpërblejeni sjelljen e oponentit.
- Shpreheni mirënjohjen.
- Përkujtojani oponentit obligimet e roleve.
- Ndihmojeni oponentin në punën gjatë qëndrimeve negative.
- Ktheni favoret.
- Luftojeni antagonizmin, jo antagonistin.

Egoja është tradhti

Nuk mund ta revolucionarizojmë popullin dhe shoqërinë e Kosovës, pa e revolucionarizuar Lëvizjen tonë. Dhe, nuk mund ta kërkojmë këtë pa qenë të gatshëm

secili prej nesh ta revolucionarizojmë vetveten dhe jetën tonë. Egoja e papërmbajtur, anëtarin e një subjekti politik a organizate shoqërore e shpie te kundërshtarët.

Sipas Jacques Lacanit, instikti i supozuar i egos për vetëruajtje me vetëdëshirë tërhiqet para tundimit për ta dominuar hapsirën, kurse frika nga vdekja psikologjikisht i nënshtrohet frikës narcistike të lëndimit të trupit.

Si persona, aktivistët e Lëvizjes kanë dallime të ndryshme me njëri-tjetrin. Por, koncepti na bashkon dhe na bën alternativë. Pra, e përbashkëta konceptuale ndodhet para dhe mbi dallimet personale.

“Çdo individ është përgjegjës për formësimin e jetës së vet, sidoqoftë kolektivisht ne e formësojmë një komunitet që e bën këtë gjë të mundshme. (...) Njerëzit e siguar krijojnë më shumë, sepse ata guxojnë të bëjnë më shumë.” (“Each individual is responsible for shaping his own life, however collectively we shape a community that makes this possible. (...) Secure people create more, because they dare to do more.” – Partia Laburiste Norvegjeze

Aktivistët duhet të jenë aktivë, jo vetëm jashtë Lëvizjes por edhe brenda saj. Ata duhet të shprehen hapur e lirshëm e shpesh, jo vetëm për të ndikuar por edhe pse duhet të dihet se kush janë. Aktivisti i cili nuk flet në mënyrë që të mos merret vesh padituria ose karakteri i tij është kërcënim për Lëvizjen.

Tendenca për të gjetur përmbushje më parë jashtë punës dhe angazhimit politik sesa brenda tij, është e dëmshme për Lëvizjen tonë. Individët që janë individualistë preferojnë grupe të vogla si zëvendësim për shoqërinë dhe bashkësinë në prirjen e tyre për privilegje. Individualizmi duke qenë i pamjaftueshëm sjell te krijimi i grupeve subkulturore, pra i kllapava apo klikave.

Cinizmi i vazhdueshëm dhe shakatë e tepërta e rrënojnë disiplinën në një organizim. Cinikët thonë se ajo që po ndryshon është e kotë, kurse obskurantistët thonë që asgjë s’po ndryshon. Egoisti nuk di si të përballet me këta.

Nuk ka mobilizim pa zemërim dhe shpresë. Cinikët e shtresës së epërme të klasës së mesme nuk i kanë asnjërin.

Nga pikëpamja revolucionare patetizmi është sabotim (sikurse edhe gjithçka tjetër dekurajuese). Për më keq, një pjesë e mirë e rinisë kosovare është bërë shumë e qetë dhe e butë sepse marrin shumë marihuanë. Nismat e ndërmarrjet mobilizuese (madje, edhe vetëm si të tilla) janë progresive.

Ndryshimet në Kosovë do t’i sjellin masat e popullsisë. Ne jemi këtu për ta përshpejtuar dhe lehtësuar këtë. Regjimi dëshiron ta përforcojë besimin te njerëzit se historinë e bëjnë individët liderë të jashtëzakonshëm e jo masat popullore e qytetarët.

Burokratët ndërkombëtarë në Kosovën e pasluftës kanë inkurajuar krijimin e shumë partive, e kanë copëtuar elitën politike, dhe mandej i kanë bërë bashkë: individualizim e

totalizim, siç ka thënë Michael Foucault. 80% të ndërmarrjeve në Kosovë e kanë një të punësuar.

Nuk mund të ketë barazi të subjekteve egoiste pa kurrfarë solidariteti. Asisoj shoqëria bëhet realisht e pamundur. Ne jetojmë bashkë me njëri-tjetrin në shoqëri kurse vdesim vetëm si individ. Neoliberalizmi synon ta organizojë jetën rreth vdekjes, rreth individit të vetëm.

Janë të shumtë ata që ankohen në popullin: populli kështu, populli ashtu. Shikohet faji te vetvetja si popull, jo tjetërkund, por ama si popull që s'jemi asnjëri prej nesh, e jo te vetvetja si individ. Kur një intelektual i thotë Ukshin Hotit "Nuk kishim pasur popull por vetëm fis", ja se çfarë shkruan Ukshin Hoti: "Ndoshta vërtetë ishte kështu, por ky nuk kishte të drejtë ta thoshte një gjë të tillë. "Qen bir qeni, - thashë me vete, - e dëshiroje luftën por jo edhe përgjegjësinë!" Me imoralitetin e këtij qëndrimi e katandisën çdo moral në gjendje të amullisë shpirtërore të një populli të tërë dhe pastaj me një paturpësi të hapur deklamonin se nuk kishte pasur popull por vetëm fis dhe për këtë i fajësonin edhe të vdekurit dhe jo veten e tyre."

Në kapitalizmin liberal-demokratik të drejtat janë liri negative për individët e izoluar që paraqesin rrezik për njëri-tjetrin. Të drejtat gëzohen individualisht, mirëpo ato fitohen kolektivisht. Të drejtat e njeriut nuk bën të jenë të drejtat e njeriut egoist. Përderisa kemi ligjin e shansit individual nuk mund ta kemi shansin për ligj kolektiv. Duhet të jemi jo vetëm individë të lirë që bëjnë transaksione ekonomike por qytetarë të përgjegjshëm që kanë obligime ndaj shoqërisë në Republikë. Solidariteti është më i rëndësishëm sesa diversiteti.

Orientimi neoliberal konsideron që liria e tregut është e mjaftueshme për të siguruar lirinë e individit. Ideologjia e parë që të bie në dorë në Kosovë është neoliberalizmi, prandaj nuk mund të thuash që e ke zgjedhur neoliberalizmin por veçse që ke qenë i zgjedhur prej tij. Egoistët neoliberalë nuk mund të jenë krenarë.

Individualizmi është bërë tejet i kushtueshëm për shqiptarët: prej fermave njëhektarëshe e deri te protagonizmi në politikë. Të drejtat individuale zhduken në kolektivitet të paorganizuar: aty ka veçse liri individuale të eklipsuar nga frika prej lirisë së tjetrit. Në anarki vdesin edhe bashkësia edhe individualitetet porse lindin bandat dhe personalitetet. Bashkësia politike e organizuar është kushti dhe mundësia për lirinë. Dhe, organizata i bën dëshirat (individuale) vullnet (kolektiv). Ligji e mbron punëtorin individualisht. Sindikata i jep fuqi kolektive.

Individualizmi i shumicës dërrmuese të grave politikane dhe të shquara në Kosovë është shumë më i madh sesa feminizmi i tyre dhe fatalisht e minon feminizmin e tyre. Për çdo ditë shohim si individualiteti garues e mund dhe rrënon solidaritetin gjinor.

Secili njeri frikësohet tepër. Egoja i bën të harrojnë që jo gjithçka ka të bëjë me secilin prej tyre. Egoja vjen nga frika dhe frika vjen nga egoja. Egoja objektifikon.

Disa njerëz duke mos mundur të jenë të parët, propagojnë se si janë të vetmit, se si vetëm ata kanë mbetur. Në fakt, ata janë të vetmuar, ndjehen të vetmuar, dhe egoja i shtyn nganjëherë të krekosen e nganjëherë të ngushëllohen me këtë.

Lëvizjes i nevojitet mendimi kritik i cili mund të jetë edhe ndryshe, por jo mendimi ndryshe *per se*. Te mendimi ndryshe theksi bie te kjo ‘ndryshe’! Tek ata që lavdërohen me mendimin ndryshe, zakonisht e shohim këtë ‘ndryshe’, por jo edhe mendimin. Respektohet mendimi individual sa më i varfër të jetë ai. Një fjalë e urtë kineze thotë që një mendje është hiç mendje, dy mendje janë gjysëm mendje, ndërsa tri mendje e bëjnë një mendje!

Edhe materia mendon, porse ky është mendimi më i varfër i mundshëm: aq sa lejon rezistenca e materialit. Psh. uji ecën aq sa lejohet, ndjek rrugën më të kolljashme. Kësisoj do të mund të thuhej që ndjekja e rrugës më të lehtë është mendim aq i varfër saqë s’është fare mendim.

Kur njerëzit arrijnë ndonjë sukses në punë, karrierë, profesion etj. zakonisht harrojnë sesa shumë njerëz të tjerë i kanë ndihmuar e kanë bashkëvepruar me ta. Karakteri kolektiv i ndërmarrjeve kollaj abstrahohet. Neoliberalizmi e do njeriun si veprim individual dhe zgjedhje racionale duke i nënvlerësuar lidhjet shoqërore. Kosova ka nevojë për progresin shoqëror (si rregull) e jo vetëm për sukseset individuale (si përjashtim). Nuk mund të jemi të lirë e me mirëqenie si qytetarë individualisht pa qenë e tillë Kosova si shtet, si shoqëri e si popullsi.

Në Kosovë ka shumë më tepër njerëz që e duan rehatinë sesa aso që e duan suksesin. Dhe, ata që e duan suksesin prishin rehati, por ata që e duan rehatinë shumë edhe durojnë shumë.

Individualja është bërë personale. Jo më egoja, por një ego e veçantë, unike. Kur i thua dikujt: “personalisht”, je duke i thënë që ai/ajo nuk mund të të kuptojë. Vetë-mjaftueshmëria e rrejshme dhe progresi si progres i teknologjisë së aplikueshme ka shpjer në mbyllje të qytetarit që konsumon mallra dhe imazhe. “Imagjinata, dëshira, kreativiteti individual, të gjitha ato gjëra që është dashur të çlirohen në revolucionin e fundit, janë kufizuar rigorozisht në domenin e konsumerizmit, ose ndoshta në realitetet virtuale të Internetit”. (“Imagination, desire, individual creativity, all those things that were to be liberated in the last great revolution, were to be contained strictly in the domain of consumerism, or perhaps in the virtual realities of the Internet.”) – David Graeber

Televizori i lokalizon njerëzit nëpër familjet e tyre. Kompjuteri i individualizon mandej. Teknologjia dhe zhvillimi i saj për masat konsumuese është në funksion të atomizimit të shoqërisë. Ajo gjithsesi duhet përdorur për informim por jo pa këtë vetëdije kritike mbi të. “Të kundërshtosh individualen me kolektiven do të thotë të transformosh individimin në atomizim shoqëror, duke prodhuar një tufë. Shoqëritë tona të supozuara si individualiste janë në të vërtetë në mënyrë të përsosur konformiste.” (“To oppose the individual and the collective is to transform individuation into social atomization, producing a herd. Our supposedly individualistic societies are in reality perfectly

conformist.”) – Bernard Stiegler. Individualizmi nuk është aspak autentik sot. Ai është pasojë e konsumerizmit dhe mirëmbajtje e tij.

Pushteti do që njerëzit të mendojnë kolektivisht e të veprojnë individualisht. E kundërta nevojitet: të mendojmë individualisht e të veprojmë kolektivisht. Në videoklipin ‘Young Europeans’ të fushatës qeveritare njëherë secili është individ dhe mandej bëhen bashkë përmes një pune teknike me qëllim performativ. Kolektiviteti është performancë në postmodernitet. Dhe, rezultati final është instalacion.

Në qeli burgu të izolojnë për të të thyer shpirtërisht. Kur je i pakënaqur, sado i pakënaqur të jesh, po e mendove veten si individ dhe vetëm si individ, atëherë përkundrazi regjimit sigurisht që je i pafuqishëm. Individuimi postmodern sot realizohet përmes ekranit që e kundron, si Ipad, Iphone, Ipod... Pra, teknologjia është individualizuese dhe, më tutje, personalizuese: PC do të thotë Personal Computer. Porsi furça e dhëmbëve ose brekët që janë personale.

Liberalizmi i shtyp njerëzit si shqiptarë që janë, dhe meqë ata duan t’i përkasin një bashkësie a grupi, meqë e duan ndjenjën e përkatësisë, bëhen më të përshtatshëm për t’u inkuadruar në klane, subkultura, sekte a religjione. Fundja edhe shoqëria nuk përbëhet prej individëve por më parë prej grupeve të vogla shoqërore. Pra, nuk është çështja që liberalizmi vetëm të individualizon në shoqëri të cilën e shkërmoq, por brenda individit e shtyp përkatësinë kombëtare mu në rrethanën kur kombi e forcon shoqërinë.

Jo pak sulme që i bëhen kombit shqiptar nga analistë e publicistë të ndryshëm janë sulme me nënshtrat neoliberal: ata e sulmojnë bashkësinë dhe kolektiven, andaj e sulmojnë kombin shqiptar. Madje, nganjëherë janë tepër spontanë për të mos qenë të pavetëdijshëm.

Në kapitalizëm prodhimi është kolektiv kurse produkti përvetësohet nga individ i pronar. Shoqërizimi ndodh sërish në treg aty ku njerëzit bashkërisht shesin e blejnë dhe mandej sërish individualizohen në konsum. Konsumi individualizon. Prodhimi kolektivizon.

Meqë konsumi individualizon, kur konsumon, atëherë shtohet besimi në zot, sepse ‘secili për vete, zoti për të gjithë’. Kur prodhon a lufton në betejë zoti tretet sepse bëhesh ‘të gjithë për secilin dhe secili për të gjithë’, pra të ndërvarur dhe solidarë.

Bashkësia (s’është) ndërkombëtare

Bashkësia ndërkombëtare nuk është as bashkësi dhe as ndërkombëtare. Ajo është konglomerat interesash të ndryshme të shteteve të veçanta dhe korporatave të fuqishme. Në shekullin e kaluar korporatat ishin nacionale e i tillë ishte edhe (neo)kolonializmi, pra një shtet a komb okuponte dhe kolonizonte tjetrin. Tash, korporatat janë bërë multi-nacionale e ashtu është bërë edhe sundimi e kolonizimi i huaj që e shpall veten protektorat ndërkombëtar. Nuk është e rastësishme që Qeveria e Kosovës është shndërruar në administratë të korporatave Bechtel-Enka dhe Limak-Çalik. Instalimi i parimit (të privatizimit si bindje dhe i infrastrukturës si asfalt) si mohim i planit

ekonomik derivon nga instalimi i tregut të lirë në shoqërinë njerëzore. Kosova është bërë vend i shkëmbimit dhe i konsumit. Ne kemi nevojë ta bëjmë atë vend edhe të prodhimit dhe të shpërndarjes.

Qeveria e Kosovës nuk i sheh faktorët ndërkombëtarë si interesa por si vlera, prandaj, nuk flet aq për aleanca (ushtarake) dhe partneritete (ekonomike) por për miq ndërkombëtarë (sic.). Fundja, mënyra se si qeveritarët kosovarë flasin për tregun e lirë, për globalizimin, për perëndimin etj. është mënyrë religjioze e fetare. Veçse miqtë ndërkombëtarë janë miq të status quo-së. Ata duan stabilitet më parë se zhvillim, paqe më parë se drejtësi, siguri më parë se demokraci. Faktorët ndërkombëtarë në Kosovë e rreth Kosovës e preferojnë status quo-në në Kosovë kundrejt drejtësisë dhe, sërish, status quo-në kundrejt zhvillimit. Drejtësinë dhe zhvillimin jo vetëm që i shohin si ndërmarrje me rrezik por, madje, edhe si ndërmarrje të rrezikshme.

Protektorati ndërkombëtar në Kosovë edhe ka imunitet prej ligjit, edhe nuk na njeh si shtet, edhe nuk na jep llogari si institucione, edhe ka fuqi ekzekutive që janë të pakufizuara si në kohë po ashtu edhe në gamën e tyre. Protektorati ndërkombëtar është jodemokratik në veten e tij dhe jodemokratik ndaj Kosovës. Ky protektorat ndërkombëtar e ruan elitën nga populli e jo anasjelltas teksa na la pa ushtri dhe pa ekonomi e me tepër shumë politikë të kotë. Prandaj në Kosovë nuk kemi punë e aksion dhe kemi tepër shumë debate e polemika. Protektorati ndërkombëtar, i ndjekur nga Qeveria e Kosovës, në një rënë anë, me politikën e tyre e thelloi dallimin midis të pasurve e të varfërve, e në anën tjetër, kërkon stabilitet. Paradigma e stabilitetit ndryshe quhet edhe menaxhim i krizës. Mirëpo, menaxhimi i këtillë është gjithësesi i papërshtatshëm: nëse kriza është e mirë, pse duhet menaxhuar; nëse është e keqe, pse nuk duhet zgjidhur ajo?

Ambasadorët amerikanë që ndërrohen në Kosovë s'para vizitojnë VETËVENDOSJE!-n. Ata njëherë po i takojnë politikanët e korrumpuar dhe janë shumë të zënë në komunikim e bashkëpunim me ta. Politikanët e pakorrumpuar i kanë lënë për fund. Veçse radha e politikanëve të korrumpuar, që gjithësesi kanë prioritet, është shumë e gjatë. Prapambeturia e shteteve të Ballkanit perëndimor është proporcionale me dëgjueshmërinë e tyre ndaj faktorëve ndërkombëtarë.

Vizita jashtë vendit – ky, pra është preokupimi kryesor i qeveritarëve kosovarë dhe i politikanëve koniukturalë në përgjithësi. Dikur, fjala vizitë thuhej zakonisht për vizitën te mjeku. Ndoshta tash mjeku i këtyre politikanëve pacientë është në Bruksel, Uashington, Berlin, Londër, Paris e Nju Jork. Dhe, çdo herë kur kthehen nga udhëtimet jashtë vendit, qeveritarët kosovarë e kanë vetëm një rezultat: rikonfirmimin e perspektivës (evropiane)! Përmirësimin e gjendjes së pacientit të hospitalizuar por pa leje për të dalur nga spitali, sepse gjendja është e qetë por e tensionuar!

Nga marrëdhënia i burgosur-gardian në kohën e okupimit të Serbisë kemi kaluar te marrëdhënia pacient-doktor në kohën e protektoratit ndërkombëtar dhe në vijim duhet të kalojmë në atë student-profesor te integrimi në BE. Nga burgu në spital, nga spitali (shpresojmë) në shkollë.

Serbia ka politikë armiqësore ndaj Kosovës dhe shqiptarëve. Çfarëdo ndërmjetësimi ndërkombëtar duhet të fillojë nga këtu. Politika e palës më të fuqishme duhet të trajtohet, kritikohet e gjykohet para asaj të palës më të dobët, apo jo?

Faktorët ndërkombëtarë në Kosovë nuk po na e largojnë Serbinë prej Kosovës. Përkundrazi, ata po kërkojnë që ne ta tolerojmë Serbinë brenda vetes sonë. Ta tolerojmë ekonominë dhe mallrat e saj të cilat na kanë vërsuar meqë hyjnë pa doganë, dhe ta tolerojmë Serbinë në formën e strukturave paralele që po konsolidohen në Zajednicë. S'ka përparim pa ndryshuar kjo situatë e këtillë.

Shqiptarët janë përgjithësisht të mirë, kjo është mirë, por ata përgjithësisht nuk janë mirë. Kosova vazhdon të jetë nën protektorat ndërkombëtar të paafatizuar. Ajo shihet si pjesë e ndjeshme e rajonit prej Bosnjes te Maqedonia, prej Vojvodinës te Shqipëria. Në trajtimin e politikës së jashtme, duhet sqaruar se katër fuqi të mëdha shtyhen në Ballkanin perëndimor: ShBA-ja, Rusia, Gjermania e Turqia. Në çdo analizë duhet t'i kemi parasysh interesat e fuqive të mëdha, gjendjen e masave popullore dhe marrëdhëniet ekonomike, para interesave të individëve sado të zellshëm që të jenë ata. Ne si shtet i Kosovës e si komb shqiptar, nuk kemi nevojë për aleatë të ri, por për aleanca të reja. Me ShBA-të, Gjermaninë dhe Turqinë na nevojitet një cilësi e re e marrëdhënieve posaçërisht në aspektin ushtarak dhe ekonomik. Kombi shqiptar duhet të krijojë aleanca strategjike brenda Ballkanit me Kroacinë (për shkak të Serbisë me Bosnjen) dhe me Bullgarinë (për shkak të Maqedonisë). Kursesi nuk duhet që të themi se Serbia e ka Rusinë kurse ne shqiptarët e kemi Amerikën sepse kjo e mirëmban inferioritetin dhe pafuqinë e shqiptarëve të cilët ndjehen më rehat duke u kompensuar psikologjikisht me Amerikën e duke mos u organizuar për t'u fuqizuar vetë.

Ndonëse mendohet ndryshe, shqiptarët disi nuk i duan përnjëmend ShBA-të. Ata frikësohen se mund të braktisen prej tyre dhe gabimisht besojnë se mund të luajnë rol në mosbraktisje, ashtu qysh gabimisht besojnë se nuk mund të luajnë rol për fatin e vendit të tyre. Shqiptarët kanë shumë më tepër peshë për fatin e tyre në Ballkan sesa në lidhjen e tyre me ShBA-të. Fundja, janë ShBA-të ato që i kanë përzgjedhur shqiptarët për bashkëpunim e jo anasjelltas.

Duke thënë që NATO-ja na çliroi, ne bëjmë që NATO-ja dhe perëndimi të ndjehet me faj për sulmin mbi Serbinë dhe asisoj Serbia të ngajë e arsyeshme kur kërkon të dëmshpërblehet dhe kompensohet për humbjen e Kosovës si rezultat i (bombardimeve të) NATO-s së cilës ajo s'i kishte bërë gjë! Luftën me shumë mund e sakrifica e bëri populli i Kosovës me në krye UÇK-në gjersa perëndimi ndihmoi shumë me bombardimet 78 ditore të NATO-s kundër ushtrisë së Jugosllavisë së Milosheviqit.

Politikanët e diplomatët ndërkombëtarë na vijnë në Kosovë me njëjërën nga dy kapelat: si përfaqësues e zyrtarë shtetesh që na kanë njohur, apo si ndërmjetësues në dialogun e Kosovës me Serbinë. Gjithnjë e më shpesh vijnë në këtë rolin e dytë, pra me kërkesat e Serbisë në Prishtinë, kurse në Beograd shkojnë me kërkesa tonat, nëse ka të tilla. Prandaj,

nuk duhet ta ngatërrojmë zyrtarin e shtetit njohës që vie në kuadër të marrëdhënies bilaterale me kapacitetin e misionin e tyre si ndërmjetësues me aurë neutraliteti.

Ka një fushatë të madhe kundër kombit shqiptar në emër të luftimit të nacionalizmit të shqiptarëve. Ama kollaj është ta luftosh nacionalizmin shqiptar sepse shqiptarët janë të varfër, janë komb i varfër. Le ta luftojnë nacionalizmin e kombeve të pasura apo të atyre me shtete të fuqishme, apo jo? S'ke çfarë krenohesh me luftimin e nacionalizmave të kombeve të varfëra. E, nëse secili duhet ta luftojë nacionalizmin e popullit a kombit të vet, kjo s'paraqet kurrfarë parimi e as dobie. Në një situatë të dhënë (gjeo)politike kombet e nacionalizmat s'janë as të njëjtë dhe as të barabartë. Dhe, kur thua se i përket një kombi të caktuar, çka do të thotë kjo saktësisht, sepse ndoshta duhet pyetur edhe kombin për ty!?

Bashkimi Evropian nuk do që ta federalizojë as mirëqenien dhe as borxhin, as prodhimin e as punësimin, por sovranitetin shtetëror të vendeve anëtare. Prandaj, bashkimi në BE s'është shoqëror. Portretizimi ynë si muslimanë të rrezikshëm të cilëve nuk u duhet hequr regjimi i vizave është racionalizim i mbrojtjes së tregut të punës.

Integrimi në BE nuk realizohet thjesht duke e pasur qëllim atë, por si pasojë e zhvillimit dhe emancipimit të brendshëm të shtetit dhe shoqërisë. Jo duke dalë nga vetja por duke u bërë vetja, duke u ribërë vetja. Gjermanët, italianët e francezët nuk janë evropianë duke mos qenë gjermanë, italianë apo francezë, por pikërisht pse janë gjermanë, italianë e francezë. Kësisoj, në kontekstin tonë, është e pamundur që ne të bëhemi evropianë duke mos qenë shqiptarë. Në fakt, e vetmja mënyrë se si mund të jemi evropianë, në kuptimin e qytetarit evropian, është pikërisht duke qenë shqiptarë.

Në vitin e kaluar janë bërë 300 vjet nga Traktati i Utrecht-it, i cili ia dha Gjibraltarin Britanisë. Bashkë me Spanjën edhe Britania e Madhe sot është anëtare e BE-së, mirëpo Gjibraltari vazhdon të jetë pjesë e Britanisë së Madhe. Shtetet kur hyjnë në BE i konfirmojnë dhe i forcojnë kufijtë e tyre, nuk i relativizojnë ata siç ekziston bindja e përgjithshme. Kufiri midis Francës dhe Gjermanisë në BE, është kufi pothuajse inekzistent për francezët dhe gjermanët si individë, ndërkaq për Francën dhe Gjermaninë si shtete kurrë nuk ka qenë kufi më i fuqishëm. Prandaj të gjitha shtetet që hyjnë në BE nuk i dobësojnë kufijtë, përkundrazi i konfirmojnë dhe i forcojnë kufijtë: atje kufijtë bëhen pothuajse të paqenë për qytetarët, e jo për shtetet. Pas luftës së dytë botërore, shtetet e ndryshme evropiane i kanë normalizuar marrëdhëniet në kushtet kur nuk kishin më pretendime territoriale dhe kishin njohje reciproke, psh. Franca me Gjermaninë. Por ky assesi nuk është rasti i Kosovës me Serbinë. Shteti është shtëpia e popullit. Pa të, je refugjat (ndonëse) në tokën tënde.

Ne e duam bashkimin me Shqipërinë në mënyrë demokratike e paqësore. Atëherë, përse shqetësohen faktorët ndërkombëtarë? A mos ndoshta po frikësohen nga reagimi jodemokratik dhe jopaqësor i Serbisë? Veçse kjo paraqet edhe një konfirmim shtesë se Serbia është problemi, apo jo? Me rëndësi parësore për neve është që nacionalizmi ynë të jetë me karakter revolucionar.

Serbia nuk ka humbur pse ka fituar Kosova por pse është çliruar Kosova që do të thotë se nuk kanë humbur serbët por serbomëdhenjtë. E arritur kombëtare shqiptare do të jetë ajo e cila e ndërpreu rrudhjen e tkurrjen territoriale të shqiptarëve. Çkado që shpallim a nënshkruajmë, çfarëdo sukseesi që proklamojmë, është i kotë nëse nuk e ndalon shpopullimin e trojeve të banuara me shqiptarë në skajet e tij si Tivar e Ulqin, Tuz, Plavë e Guci, Mitrovicë, Medvegjë e Bujanoc, Kumanovë e Shkup, Ohër e Manastir.

Serbët s'janë Serbia

Fakti që shqiptarët janë komb i fuqishëm, por me shtete të dobëta, kurse serbët janë komb më i dobët se ne, por me shtet të fuqishëm, është një mënyrë tjetër për të thënë që konflikti në Ballkan është midis shqiptarëve si komb dhe Serbisë si shtet, pra jo thjesht konflikt etnik dhe as shqiptaro-serb. Nuk ka nevojë që të pajtohen shqiptarët me serbët a serbët me shqiptarët, nuk ka nevojë që të pajtohen as Serbia me shtetin e Kosovës dhe madje as serbët me shtetin e Kosovës, por para së gjithash e mbi të gjitha, të pajtohet Serbia me shqiptarët si komb, ekzistencën, të drejtat dhe legjitimitetin e tij.

Në fillim të shekullit XX, Serbia e krijoi Jugosllavinë për t'u zgjeruar. Në fund të shekullit XX, Serbia e shkatërroi Jugosllavinë për t'u zgjeruar. Pasardhësit politikë të Milosheviqit e Sheshelit janë në pushtet në Beograd: Vuçiqi, Nikoliqi e Daçiqi. Politikanët serbë që nuk janë të trashëgimisë së Nikola Pashiqit nuk kanë ndikim në Serbi. Akademia e Shkencave dhe e Arteve të Serbisë, ushtria e policia serbe si dhe Kisha Ortodokse e Serbisë janë pushtete mbi shtetin e Serbisë. Këto historikisht ideojnë, planifikojnë dhe ushtrojnë orientimin politik të Serbisë, përkatësisht aspiratat e saj ekspanzioniste dhe hegjemoniste.

Para më shumë se 20 vjetëve faktorët ndërkombëtarë na thoshin se demokratizimi i Serbisë nevojitet para pavarësisë së Kosovës. Sot na thonë që evropianizimi i Serbisë nevojitet para sovranizimit të Kosovës. Herën e parë e kishin gabim, edhe herën e dytë e kanë gabim.

Dialogu që u zhvillua nga viti 2011 deri më 2015 me Serbinë ishte dialog sipas kushteve të Serbisë: të diskutohet për çështje të brendshme të Kosovës, pa u konsideruar Serbia si borxhli ndaj Kosovës dhe shqiptarëve. Qeveritarët kosovarë që negociuan e bënë këtë për shkak të shantazheve ndërkombëtare për korrupsionin e tyre vendës si dhe për shkak të kompleksit të inferioritetit ndaj ndërkombëtarëve dhe serbëve. Qeveritarët kosovarë, rregullisht ia përmendin UÇK-në popullit të Kosovës, jo ndërkombëtarëve, dhe, ia përmendin krimet e Serbisë sërish popullit të Kosovës e jo Serbisë me të cilën bëjnë dialog e marrëveshje në Bruksel.

Dikur Serbia dirigjonte me serbët në Kosovë përkundër perëndimit (BE, NATO). Sot dirigjon lëmueshëm me ta. Serbia e pranon Planin e Ahtisarit si dysheme a themel të Kosovës por jo edhe si tavan a kulm të tij. Ajo e do Kosovën shtet të hapur për Serbinë, shtet që i ulet vazhdimisht tavanin në drejtim të dyshemesë apo që mbetet i pambrojtur sepse pa kulm. Ne kemi nevojë të kalojmë nga decentralizimi mbi baza etnike

(decentralizimi rreth ndejës ku shqiptarët rrinë me shqiptarë ndërsa serbët me serbët) te decentralizimi për zhvillim (decentralizimi rreth punës prodhuese që sjell të mira të përbashkëta dhe individuale). Mjetet e punës nuk ankohen për përkatësinë kombëtare të duarve të punëtorit që i shtrëngojnë ato.

Dialogu politik në Bruksel midis Kosovës e Serbisë, nga qeveria e Kosovës argumentohet edhe me nevojën për integrimin e serbëve të Kosovës. Në fakt, sa herë që kemi pasur bisedime e negociata midis Kosovës e Serbisë janë përdorur serbët e Kosovës: nga Prishtina zyrtare kinse për integrimin e tyre, kurse nga Beogradi zyrtar kinse për mbrojtjen e tyre. Qeveria e Kosovës flet për integrimin e serbëve që të jetë sa më e pranueshme nga faktorët ndërkombëtarë dhe t'ua zbusë zemrën atyre që ia kanë dosjet e korrupsionit dhe krimit të organizuar. Ndërkaq, Qeveria e Serbisë flet për mbrojtjen e serbëve në Kosovë për ta rritur hegjemoninë e vet, me ç'rast serbët lokalë janë mjete për territor dhe pasuri natyrore e jo anasjelltas. Kësisoj, oportunitizmi i Prishtinës bëhet komplementar me hipokrizinë e Beogradit.

Integrimi i vërtetë dhe i qëndrueshëm është integrimi shoqëror e jo ai institucional. Për integrimin institucional do të mund të thuhej se është i nevojshëm por kursesi i mjaftueshëm. Integrimi institucional është integrimi përfaqësuesve të serbëve dhe jo i serbëve. Prandaj, integrimi i kufizuar tek ai institucional është i brishtë. Na kujtohet mirë p.sh. rasti i Oliver Ivanoviqit i cili për tetë vjet rresht ishte integruar në institucionet e Kosovës por mandej u bë zyrtar i lartë në Qeverinë e Serbisë. Integrimi institucional është elitë, është integrim i elitës. Përmes këtij integrimi diku mirëmbahet e diku edhe prodhohet elita por nuk integrohet komuniteti.

Integrimi institucional është integrim prej lart-poshtë. Kosova ka nevojë për integrim prej poshtë-lart. Integrimi prej lart mbetet lart dhe nuk mbërrin poshtë. Integrimi prej poshtë arrin edhe lart. Integrimi prej lart-poshtë është koniuktural. Integrimi prej poshtë-lart është demokratik. Dhe, mbi të gjitha është shoqëror, është integrim në shoqëri. Ne i përkasim kombeve të ndryshme por jemi në të njëjtën shoqëri. Dialogu me serbët e Kosovës, në kontrast me atë dialogun e gabuar me Serbinë, duhet të jetë i hapur dhe demokratik me qytetarët dhe jo i mbyllur në zyra dhe diplomatik me zyrtarët.

Megjithatë, kur them dialog e integrim shoqëror nuk mendoj te seminarët, konferencat e trajnimet e OJQ-ve në kohën e pasluftës por te barazia si vlerë e synim, te shteti i së drejtës dhe zhvillimi ekonomik i bazuar në prodhim. Integrimi është çështje e barazisë dhe jo çështje e tolerancës. Në fabrika dhe universitete thuret shoqëria. Sepse aty krijohet solidariteti i punëtorëve dhe bashkëpunimi i studentëve.

Shkolla (është) Politike

Shkolla Politike e Lëvizjes duhet të ofrojë arsimin socio-politik dhe ekonomik për aktivistët si dhe edukim etik dhe estetik për ta. Në veçanti duhen mësuar logjika dhe formulimi i argumenteve e ndërtimi i pozicioneve për debate. VETËVENDOSJE! duhet ta fitojë çdo debat. Numrat i fitojmë në fund.

Lëvizja nuk do të mund ta ndryshojë gjendjen gjersa nuk e ndryshon popullin, e jo thjesht gjersa nuk e ndryshon regjimin. Ndryshimi i regjimit pa ndryshim të popullit është ndërrim regjimestësh. Shkon një sundimtar vetëm për t'ia lënë vendin tjetrit. Ky popull, kështu siç është, paraqet produkt të regjimit dhe njëkohësisht e mundëson (dhe e mirëmban) atë. Mirëpo, për ta ndryshuar popullin që ta ndryshojmë regjimin për hir të popullit duhet së pari ta ndryshojmë veten tonë, të arsimohemi dhe edukohemi, të ngritemi sepse do të emancipohemi.

Dy tipe të shkollës politike i nevojiten VETËVENDOSJE!-s, njëra dyvjeçare me 20 aktivistë të përzgjedhur (filozofi, ekonomi politike, sociologji, antropologji, psikologji) e tjetra njëvjeçare me 200 sosh (Alternativa Qeverisëse, argumentet për qëndrimet e VETËVENDOSJE!-s, shpjegimi i konceptit, strukturës, historikut dhe mënyrave të Lëvizjes). Tek të gjithë aktivistët duhet të zhvillohen aftësitë reproduktuese të diskursit, programit dhe qëndrimeve tona. Shkolla politike e Lëvizjes nuk duhet të merret me aktivistët që t'i bëjmë ata militantë intelektualë dhe të kufizohet tek ata. Por, të merret sidomos me ata që u anëtarësuan dhe ende s'janë bërë aktivistë.

VETËVENDOSJE! duhet ta afirmojë Rilindjen Kombëtare, të gjysmës së dytë të shekullit XIX dhe gjysmës së parë të shekullit XX. Ta riaktualizojë si frymë e përgjithshme dhe si shumësi tekstesh të rilindasve tanë, nga Sami Frashëri te Fan Noli.

Lëvizja duhet të jetë njëkohësisht shkollë dhe parlament, sikurse teatri epik i Bertolt Brechtit. Lëvizja duhet të bëhet shkollë: mësuesi mëson nxënësit që të bëhen mësues. Lëvizja duhet të bëhet parlament: aktivistët i bashkon diskutimi i vazhdueshëm.

Shkolla Politike duhet t'i zbulojë pyetjet e dhura socio-ekonomike, politiko-institucionale, kulturore e historike ku populli është përgjigja. Sepse Lëvizja VETËVENDOSJE! është shprehje e popullit si rezistencë dhe koncept i popullit si zgjidhje. Ne jemi përcaktuar për popullin dhe s' duhet të lodhemi deri sa populli të përcaktohet për neve. Pa popullin, VETËVENDOSJE! është asgjë. Me Lëvizjen, populli bëhet gjithçka.

Nuk bën të kemi kritikë pa programe ashtu siç nuk bën të kemi as programe pa kritikë. Studimi kritik konsiston tek hulumtimi dhe analiza e temave dhe çështjeve. Ndërkaq programi te teoria, filozofia politike dhe te zgjidhjet konkrete. E majta, socialdemokracia, shteti zhvillimor, tatimi progresiv, bashkimi kombëtar, aksioni direkt, protestat, PDK-ja, LDK-ja etj. duhet të sqarohen në maksimum gjysëm faqe tekst secila për t'u mësuar masivisht. Dhe, duhet ta kemi një tekst të ilustruar se kush është Lëvizja VETËVENDOSJE!: historiku, koncepti, qëndrimet dhe metodat. Dhe, një tekst të ilustruar të shkurtër për historikun dhe aktualitetin e Kosovës e të kombit shqiptar.

Jo vetëm që njeriu mëson nëpërmjet të menduarit por edhe të menduarit mësohet. Të menduarit dialektik është i domosdoshëm për aktivistin: si mendojmë dhe jo vetëm çka mendojmë, është (edhe më) e rëndësishme në Lëvizje e për qëllimet e Lëvizjes.

Në analizat dhe studimet që i bëjmë nuk mjafton vetëm qasja përmbajtësore (mbi shkaqet dhe faktorët ndikues në një situatë) por duhet edhe ajo dinamike (mbi ndërveprimin e

atyre shkaqeve dhe faktorëve me njëri-tjetrin). Në anën tjetër, analiza socio-politike duhet ta përmbajnë komponentën e analizës gjeopolitike dhe atë të analizës klasore. Mbi të gjitha, gjendjen nuk mund të vlerësojë spektatori i brendshëm. Këtë mund ta bëjë ose vetë aktori ose spektatori tërësisht i jashtëm. Gjykimet më të gabuara duhet t'i presim prej aktivistëve pasivë.

Shumë prej atyre që bëhen anëtarë në Lëvizjen VETËVENDOSJE! jo vetëm që nuk janë aktivistë, por disi ende nuk janë as anëtarë. Anëtarësimi i tyre ishte formal dhe duhet bërë përmbajtësor. Kjo vlen edhe për qytetarët në përgjithësi, të cilët nuk janë thelluar aq te koncepti e programi ynë. Detyrë e Shkollës Politike është t'i urëzojë këto hendeqe.

Rregullisht duhet të organizohen debate gjysëmformale në Lëvizje ku ndonjëri bën një prezantim për një temë dhe mandej të tjerët diskutojnë hapur. Kafet, çaji dhe uji janë falas. Komitetet dhe Shkolla Politike përfshihen në këtë. Shkolla politike edhe edukon përveçse arsimon. Idealet e përbashkëta tashmë nënkuptojnë moralin e idealistëve. "I gjithë qëllimi i edukatës është të mbjellë në qenien shpirtërore të njerëzve kurajon dhe ndjenjën kolektive." - Alfred Adler

Shumë aktivistë tonë janë si nxënësit që dëgjojnë në klasë por nuk mësojnë në shtëpi dhe shkruajnë pak. Shkrimi mundëson thellimin, strukturimin dhe sistematizimin e të menduarit. Nuk ka organizim politik pa mendim, ide, botëkuptim dhe ligjërim të organizuar.

Nga shkolla politike përpilohen tezat që duhet dekonstruuar në takime me qytetarët. Psh. prej atyre që thonë se "Të gjithë politikanët janë të njëjtë!" e deri tek ata të cilëve qëllimi i Lëvizjes sonë shumë njerëzve iu duket gjithsesi i dëshirueshëm por jo edhe i domosdoshëm/nevojshëm (duke besuar se kjo dëshirë nuk ia vlen meqë e ka tepër të lartë çmimin). Ose, aso që thonë se Lëvizja VETËVENDOSJE! duhet të ndryshojë! Me këtë rast, ta zëmë, ka kuptim që ata të cilët kërkojnë që VETËVENDOSJE! të ndryshojë t'i konsiderojmë seriozisht e sinqerisht vetëm nëse janë për bashkim kombëtar dhe social-demokratë, apo jo? Ndërkaq, kur na e duan të mirën teksa thonë se Lëvizja duhet të ndryshojë (sepse mandej) edhe do të fitojë, atëherë, ata ose nuk e dinë (në rastin më të mirë) ose e dinë (në rastin më të keq) që qëllimi i kësaj logjike nuk është që VETËVENDOSJE! të fitojë por që ajo të ndryshojë! Ndërkohë, teza të tjera duhen të trajtohen si të dekonstruara tashmë, si psh. se VETËVENDOSJE! është ekskluzive dhe nuk bashkëpunon me të tjerët, se ajo është islamiste, se nuk ka program, etj.etj.

Forca s'është dhunë

Demokracia përfaqësuese tashmë përfaqëson sistemin dhe karakterin e tregut, më parë se popullin dhe vullnetin e tij autentik. Demokracisë në Kosovë nuk i mungon *kracia* por *demosi*. Pra, nuk i mungon sundimi (mbi popullin) por populli (që sundon).

Qeveria e Kosovës ia ka mbyllur me shul derën popullit të Kosovës andaj ai ia theu xhamat e dritareve. Në një shtet demokratik ndoshta edhe mund të mjaftojë debati për korrigjime e ndryshime, mirëpo në një vend gjysëm-autoritar a autoritar si Kosova, nuk

bën pa aksione qytetare dhe demonstrata popullore. Protesta është institucion demokratik. Ajo nuk është mjete i fundit por e drejtë e barasvlershme me të tjerat.

Në protestat e Lëvizjes VETËVENDOSJE! policia vendos paraprakisht nëse do të intervenojë apo jo. Intervenoi në Merdare dhe te Dheu i Bardhë me 14 janar 2012 dhe nuk intervenoi me 22 janar 2012. Intervenoi në Prishtinë me 27 janar 2015 dhe nuk intervenoi me 18 prill 2015. Ndërhyrja e policisë dhe dhuna e saj nuk varet fare nga të ashtuquajturat provokime të VETËVENDOSJE!-s por veçse nga plani operativ i policisë. Dhe, pikërisht dhuna reaktive e protestuesve më pas varet prej llojit e shkallës së ndërhyrjes policore në protestë.

Kur thyejmë xhama apo rrokullisim xhipa ne nuk e dëmtojmë pronën shtetërore por atë të regjimit. Sepse Kosova është shtet i kapur, sepse prona shtetërore është privatizuar tashmë. Uzurpimi është privatizim. Privatizimi është uzurpim.

Të gjithë ata që qahen për xhamat e thyer dhe dëmet materiale të shkaktuara në protestat e VETËVENDOSJE!-s janë duke i dhënë prioritet gjësendeve krahasuar me ekzistencën dhe jetën e njeriut!

Ne kemi dëmtuar dhe dëmtojmë pronë të regjimit por nuk sulmojmë për të dëmtuar policët. Michel Foucault thoshte që dhunë mund të zbatosh vetëm ndaj një subjekti që mund të të bëjë rezistencë. Pra, nuk mund të jeshë i dhunshëm ndaj gjësendeve, por vetëm ndaj njerëzve. Forca mbi gjësendet nuk është dhunë. Dëmtimi i pronës së regjimit nga aktivistët e VETËVENDOSJE!-s duhet të jetë i shpejtë si aksion dhe efikas si përmbarim.

Aksionet me dëmtim prone të regjimit duhet të mendohen mirë dhe nuk duhet t'i bëjmë sa për t'i bërë dhe kurrsesi për t'u hakmarrë. Aktivisti nuk është në Lëvizje që ta shfryjë mllëfin asnjëherë, askund mbi asnjëri, por të bashkojë e të veprojë për qëllimet e Lëvizjes.

Shumicën dërrmuese të aksioneve që disa i quajnë padrejtësisht të dhunshme i kemi bërë në Prishtinë, dhe pikërisht në Prishtinë na duan kaq shumë dhe e fituam qeverisjen lokale.

Popullsia nuk është as gjak as ujë. Popullsia është diku në mes, një lëng të cilit nuk ia dimë paraprakisht temperaturën e vlimit. Ndërkohë duhet ta nxesh vazhdimisht duke e bërë prushin flakë e flakën zjarr. Lëvizja nuk duhet të jetë si flakë e kashtës por si prush përcëllues.

Fitorja është revolucionare

As Lëvizja VETËVENDOSJE!, por as Kosova e kombi shqiptar në përgjithësi, nuk do të fitojnë pse i pëlqyen dikujt, por pse e kanë dashur shumë atë që është e drejtë dhe nevojë e tyre, vullnet dhe interes i tyre.

Në Kosovë ka nevojë për ndryshim të qeverisjes e jo vetëm për ndërrim qeveritarësh. Emrat e ri të qeveritarëve nuk shënojnë qeverisje të re. Mandej, qeverisja e re mundëson zhvillime të reja sepse në drejtime e orientime të tjera.

Në pesë vitet e para, VETËVENDOSJE! e ka kritikuar sistemin, kurse më pas regjimin. Me qasjen anti-sistem jemi dukur më liberalë. Mbase për shkak se me qasjen anti-regjim jemi thelluar te socio-ekonomia ku s'mund të jemi liberalë.

Fitorja në politikën kosovare është keqkuptuar duke u degraduar në fitore elektorale. Lëvizja nuk duhet (vetëm) ta marrë pushtetin, por (njëkohësisht) ta zëvendësojë atë me një lloj të ri të pushtetit. Njëkohësisht, është pikërisht VETËVENDOSJE! dhe vetëm ajo që don ta marrë pushtetin. Partitë tjera në Kosovë nuk duan ta marrin pushtetin. Ato duan pjesëmarrje në pushtet. Vetëm Lëvizja jonë don ta marrë pushtetin si mjet për qëllimet politike që derivojnë nga koncepti ynë. Të tjerët nuk duan ta marrin pushtetin si mjet por duan të jenë në pushtet si qëllim.

Për çështjet themelore si puna e privatizimeve neoliberale dhe negociatave me Serbinë, jo vetëm në Kosovën e pasluftës por realisht edhe në atë të paspavarësisë nuk ka pasur fare qeveri. Privatizimi dhe negociatat kanë qenë përherë të paqeverisshme. Ato kanë qeverisur me shtetin dhe qeverinë. Kjo ndryshon rrënjësisht me neve.

Nëse Lëvizja VETËVENDOSJE! fiton duke u zbutur e pse është zbutur atëherë edhe do të çahet edhe do të humbet. Sepse, kur ajo do të detyrohet të bëhet më radikale në një kohë tjetër, për këtë nuk do të has në mirëkuptimin as të strukturës së saj dhe anëtarësisë së gjerë dhe as në popull.

Ne s'do të arrijmë ta marrim pushtetin pa një gjendje të jashtëzakonshme dhe mbase as ta mbajmë atë po ashtu pa një gjendje të jashtëzakonshme për një kohë. Sepse sistemi është shumë i kriminalizuar dhe shumë kriminelë janë të lidhur me armikun tonë kryesor – Serbinë. Shteti duhet t'iu ndihmojë qytetarëve që t'i realizojnë bashkë gjërat që nuk do të kishin mundur t'i bëjnë individualisht, e jo vetëm t'i mbrojnë ata nga njëri-tjetri si pronarë. "Të gjitha revolucionet moderne kanë përfunduar në rritjen e fuqisë së shtetit." ("All modern revolutions have ended in a reinforcement of the power of the state.") - Albert Camus

Cili është kuptimi i faturave për të cilat qytetarët s'kanë mundësi t'i paguajnë? Sistemi është i gabuar. Politika kosovare karakterizohet prej premtimeve revolucionare me veprime që s'janë as reformatore. S'ka revolucion pa revolucion fiskal. Kush e beson këtë Qeveri është i dyshimtë. Kush shpreson në këtë Qeveri është i pashpresë. Popullsia është vazhdimisht në krizë, por krizë në Kosovë është dhe quhet vetëm kriza e pushtetit të rrezikuar nga populli. Dalja nga kriza kalon nëpër krizën e intensifikuar të pushtetit. S'na duhet inkuadrimi i njerëzve të rinj në këto institucione të vjetra. Na duhen institucione të reja. Pra, jo politikanë të rinj që iu bashkohen atyre të vjetër por që i rrëzojnë ata.

Kush nuk do revolucion le të shkojë në det për pushime. Kush nuk do revolucion nuk don punë. Lëvizja nuk e premtton dritën në fund të tunelit, sepse Lëvizja është pishtar. Të lëvizësh do të thotë të ecësh. Lëvizja të thotë: Mos e shtrij dorën, por ngrite grushtin!

Parulla kryesore e PDK-së “Familja, Prona, Shteti” do të thotë që Prona është bërë Pronë e Familjes kurse Shteti është Shtet i Pronës. Familja, pra as shoqëria dhe as individi. Prona, pra jo qytetari. Shteti, pra jo kombi. Renditja e këtij vizioni të PDK-së nuk është e tillë që kulmon me shtetin. Nuk është familja në funksion të pronës që është në funksion të shtetit. E kundërta vlen tek ata: Shteti i shërben pronës që i përket familjes!

Në Kosovën e pasluftës ka ndodhur një revolucion: shumë individë tejet të varfër u bënë super të pasur brenda natës. Por ky pasurim ishte i individëve dhe i tillë ishte edhe revolucioni – në jetën e individëve. Meqë këta individë kur t’i mbledhësh përbëjnë një pakicë, revolucioni ishte revolucion i pakicës për pakicën, rrjedhimisht ishte reaksion. Ne kemi nevojë për revolucion të shumicës, që shumica të pasurohet, shumica e varfër. Të varfërit e pasuruar tash kanë instaluar sistem që të pasurohen gjithnjë.

Një Lëvizje që synon ndryshime rrënjësore, për të fituar, duhet të befasojë. Që do të thotë se nevojitet një nënvlerësim i ndonjë aspekti të saj nga ana e regjimit në fuqi. Pa ilegalitet, s’ka befasi. Pa befasi, s’ka revolucion. Prandaj pushteti në Kosovë ka një lloj sikleti me Lëvizjen tonë: ajo më parë se strukturë që përshkruhet është zhvillim i pakalkulueshëm. Kur mungon demokracia sikurse te ne, opozita është më e rëndësishme sesa pushteti. Sepse pushteti, ky pushtet, do të shkojë!

Gjithnjë e më shumë mediat nuk bëjnë kurrfarë pasqyrimi të realitetit por janë shndërruar në mjete për insinuata partiake. Mbase, kjo është shenjë e situatës pararevolucionare. Qytetarët e përjetojnë realitetin në mënyrë të drejtpërdrejtë. Ata e (për)bëjnë realitetin.

Në Kosovë nuk ka tashmë reformë të suksesshme. Ka vetëm revolucion të dështuar. Revolucioni i dështuar rikuptimësohet në reformë të suksesshme atëherë kur reforma e suksesshme bëhet më shumë se ngushëllim për revolucionin e dështuar.

Me qytetarët, jopublikisht, duhet të flasim për revolucion dhe duke e përdorur këtë fjalë, ndonëse jo në fillim të bisedës. Gjendja në Kosovë është e rëndë: nga revolucioni, edhe vetëm si fjalë, populli frikësohet jo më pak sesa regjimi. Populli shqiptar i Kosovës ka bërë shumë kryengritje, porse jo edhe revolucion. Prandaj, nuk e ka lehtë ta luftojë elitën vendëse pasi që është mësuar që këtë ta bëjë vetëm ndaj okupatorëve të huaj. Revolucioni është shumë më i tmerrshëm kur flitet për të sesa kur bëhet. Ditët para revolucionit janë të mundimshme. Jo ato të revolucionit. Revolucioni vjen si çlirim.

Revolucioni sot më shumë lidhet me përmbajtjen e një sistemi dominues sesa të klasës dominuese. Hap i zhvendosjes prej karakterit social te ai politik i revolucionit. Mbase kjo vjen prej identifikimit të revolucionit me betejën e masës së revoltuar popullore kundër regjimit politik dhe jo aq me transformimin substancial shoqëror që duhet ta pasojë këtë betejë. Revolucioni ndodh atëherë kur përmbysset Qeveria porsimonarkia, e kryeministri porsimbreti.

Kosova ka nevojë për revolucion sepse duhet përmbysur klasa sunduese dhe jo vetëm sistemi politik. Kjo klasë përbëhet prej qeveritarëve dhe miqve të tyre biznesmenë, gazetarë e redaktorë mediash, gjykatës, prokurorë e avokatë, profesorë e ekspertë etj. që nuk janë pak, jo vetëm në rëndësinë dhe funksionet por edhe në numër.

Po vijmë në situatën ku revolucioni politik s'është më i mundur pa revolucion social. Heshtja e njerëzve në përgjithësi për pazaret e Qeverisë së Kosovës me Serbinë dhe fakti se katër nga pesë qytetarë të Kosovës jetojnë me më pak se 5\$ në ditë e tregojnë këtë gjë. Por, edhe jemi ç'mësuar ta shohim klasën të individit. Shohim raca, kombësi, gjini, fe e kultura, por s' shohim klasën të njerëzve. Duhet ta rimësojmë klasën.

Nuk ka fakte për të cilat pajtohen të gjithë njerëzit. Mendimet e njerëzve janë të udhëhequra prej qëllimeve e synimeve të tyre, më shumë sesa prej fakteve jashtë tyre. Nëse do të sajnim agregate statistikore të këtyre qëllimeve e synimeve sigurisht që do të përfundonim tek interesat klasore në shoqëri. Interesi individual dhe kolektiv s'janë në kundërtënie por klasat kanë interesa kundërtëne. Neoliberalët duan ta vendosin në qendër individin që s'është naiv të jetë altruist.

Revolucioni i shndërron të vërtetat teorike në vlera politike, shoqërore e njerëzore. Bota e sotme zhvillohet duke u bazuar bukur shumë në idealet e revolucionit amerikan e atij francez. E megjithatë, revolucionin nuk e bëjmë as unë e as ti dhe askush tjetër, por populli. Të djathtit mund të kenë më shumë vetëbesim mirëpo ata besojnë shumë më pak sesa të majtit në popull.

Revolucionarët patjetër që zhgënjehen me popullin dhe mandej pikërisht kjo gjë mundëson që (edhe) ata të befasonen me revolucionin. Nëse revolucioni nuk i befason edhe vetë revolucionarët, ai nuk ndodh. Thjesht, nëse revolucionarët do ta parashikonin me saktësi momentin e revolucionit, mu për këtë arsye ai ose s'do të ngjante ose do të ishte më parë një lloj puçi. Pra, revolucioni është aq i befasishtë sa që i befason edhe vetë revolucionarët. Revolucioni nuk i befason vetëm njerëzit e regjimit që përmbysen por edhe vetë 'organizuesit' dhe bartësit e revolucionit. Në fakt, kjo do të thotë që s'mund të ketë organizatorë të revolucionit. Ka vetëm njerëz të organizuar nga revolucioni.

Revolucioni nuk ndodh si zgjedhje e ndokujt, por pikërisht pse s'ka mundësi të tjera. "Liri ose vdekje!" është zgjedhje që nuk është e tillë dhe në përputhje me tezën që nuk e zgjedh njeriu revolucionin por revolucioni e zgjedh njeriun. "Revolucionet nuk bëhen, ato vijnë" ("Revolutions are not made, they come".) – Wendell Phillips. Kur ata që munden s'duan ndërsa ata që duan s'munden, atëherë krijohen kushtet për revolucion.

Pushteti edhe nëse është i shpërndarë gjithandej, ai megjithatë e ka kreun diku që për pasojë bëhet qendra e atij konteksti a situatë politike. Edhe populli i pakënaqur është gjithandej i shpërndarë nëpër territorin e shtetit. Por, nëse ai grumbullohet në qendër atëherë krijohen kushtet që fizikisht ta zhvendos kreun. Pra, revolucioni edhe nënkupton zhvendosjen dhe zëvendësimin fizik. "Revolucionet kanë sukses vetëm pse drejtohen nga politikanët kundër ushtarëve." ("Revolutions only succeed because they are conducted by politicians against soldiers".) – John Mainard Keynes

Disa njerëz besojnë që revolucioni po ndodh gjersa ai ndodh, por disa besojnë vetëm pasi që ai të jetë kryer. Natyrisht, nga ata që s'besojnë në revolucion. Më të dobishmit sigurisht se janë njerëzit të cilët besojnë se revolucioni do të ndodh, se ai mund të mos

ndodh sa është gjallë brezi ynë por edhe se mund të ndodh në një kohë përgjatë jetës së brezit tonë.

Për gjërat për të cilat nuk do të duhej fare të votohet, sepse janë tejet fundamentale për arithmetikën e numrave në Kuvend, ato nuk duhet t'i ndalim thjesht e vetëm në mënyrë institucionale. Dhe, jo vetëm pse na rikthehen. Le ta kujtojmë amandamendin nr. 24 për ndryshimin e Kushtetutës i cili i hapi rrugë Gjykatës Speciale. Ai u hodh poshtë në Kuvendin e Kosovës me 26 qershor 2015 por u rikthye me 3 gusht 2015. Aleksandër Jabllanoviq, ministri në Qeverinë e Kosovës nga Lista Serbe, u shkarkua me 3 shkurt 2015 dhe nuk u kthye. Sepse atë e hoqëm me demonstrata të fuqishme!

Kinematografia ka bërë që revolucioni të shihet si betejë epike titanësh e të neglizhohet fakti që revolucioni në të vërtetë ngjan pas revolucionit, atëherë kur lëvizja revolucionare e përdor pushtetin për ta ndryshuar rrënjësisht gjendjen, për ta transformuar përgjithmonë atë në aspektin politiko-kulturor dhe socio-ekonomik.

Në filmin “Battleship Potemkin”, qysh në fillim Sergei Eisenstein na tregon se revolucioni ndodh në një vend që s'është territor (anija), se nuk nis për bukë por kundër mishit të krimbur, se nënkupton një minimum të organizimit formal të palëve që bëhet edhe politik, dhe se shkon deri te sekondat jetë a vdekje kundër regjimit në fuqi. Revolucionin le të na e dështojnë armiqtë pse janë më të fuqishëm dhe jo ne vetë pse hezituar.

Populli i thjeshtë gjithmonë e ka më vështirë sesa revolucionarët. Sepse, ai e bart peshën e revolucionit ndërkohë që është më pak i informuar dhe pikërisht popullit i duhet ta bëjë kërcimin më të madh, shumë më të madh sesa revolucionarët, në aspektin e vetëdijes dhe emancipimit (para)revolucionar.

Postmodernizmi konsiston në vetëmjaftueshmëri (më parë personale sesa individuale) në konditat ku është pranuar pamundësia e njohjes së botës. Postmodernistët janë liberalë. Deri në momentin kur nis e vjen era revolucion. Atëherë ata bëhen konservatorë. E, revolucioni nis si liberal dhe përmbushet si radikal. Revolucioni nis si liberal, sepse në kushtet e diktaturës çështja është mungesa e lirisë së zgjedhjes. Revolucioni përmbillet si radikal sepse çështje bëhet zgjedhja e duhur kur e ke marrur lirinë me dorë. (Vuajtjet dhe humbjet njerëzit nuk i kanë nga mungesa e lirisë së zgjedhjes sa nga zgjedhjet e gabuara!) Revolucionin nuk mund të nis radikalisht dhe s'mund të përmbillet liberalisht. Sepse revolucioni nuk vjen vetëm prej zemërimit me të drejtat e shkelura por prej mosdurimit ndaj nevojave të paplotësuara.

Revolucioni ndodh kur populli bëhet skeptik për nocionin e demokracisë e jo për atë të politikës. Në Kosovë, ende fjala ‘politikë’ dhe ende jo ajo ‘demokraci’ ka konotacion përgjithësisht negativ.

Të jeshë revolucionar do të thotë të mos ndalesh as kur humb e as kur fiton, me të njëjtën shpërfillje. Revolucionin është ecje e pandalshme sipas përkufizimit. Edhe burgu për revolucionarin nuk është ndëshkim por shansë për studim. Krimineli merr dënimin, jo revolucionari.

Revolucionari i vërtetë nuk është ai që synon t'iu gëzohet fryteve të revolucionit por ai që don t'iu krijojë kushtet për revolucion. Revolucionari dhe revolucionari revolucionin nuk e kanë për veten e vet. Revolucionari ka të bëjë me mësimin e mësuesve të ardhshëm: mësuesit i mësojnë nxënësit për t'u bërë mësues të nxënësve. Ndryshimet i bëjnë masat, jo individët. Individët e dobishëm e të rëndësishëm janë ata që ndihmojnë mobilizimin dhe organizimin e masave.

"Nëse je duke kërkuar t'iu mobilizosh njerëzit drejt ndryshimit revolucionar, duhet të fillosh me dhimbjen, vuajtjen, zemërimin, panikun, ankthin, vetminë dhe frikën. Duhet të pushosh me hakmarrjen dhe erotiken." ("If you are actually seeking to mobilize people towards revolutionary change, you must start with pain, suffering, outrage, panic, anxiety, loveliness and fear. You must tarry with revenge and the erotic.") – Max Haiven. Revolucionari vjen nga dashuria joseksuale e militantëve në Lëvizje dhe urrejtja e tyre jopersonale për regjimin. Marrëdhënia seksuale pa dashuri nuk i bashkon por i ndan njerëzit. Dhe, aty s'ka vend për ironinë seksuale pa seksizëm. Për të qenë edhe më keq se kaq: hedonizmi është idiotizëm. Është kënaqësia e shfryrjes që të mban të pakënaqur. Dhe, asisoj lumturia s'arrin të bëhet as temë. "Kënaqësia edhe mund të vidhet, por dashuria duhet të jetë dhuratë." - Friedrich Schiller.

Revolucionari para marrjes së pushtetit është revolucion si ngjarje, pra me 'r' të vogël. Revolucionari pas marrjes së pushtetit është Revolucion si transformim socioekonomik, pra Revolucion me 'R' të madhe. Lëvizja revolucionare nuk humbet kur humbet, ajo mund të humbas vetëm pasi që të fitojë, duke mos e bërë kalimin nga 'r' te 'R'. Pas revolucionit vjen rendi revolucionar ose kundërrevolucionari. Përderisa në Greqi, për krizën atje, grekët fajësojnë shumë më tepër Gjermaninë sesa klasën sunduese greke, Revolucionari s'ka gjasa të ndodhë atje. "Counter-revolution is carried out by revolutionaries who become reactionary." – Paulo Freire

Shtypja e shfrytëzimi i regjimit mbi popullsinë rekruton anëtarë të Lëvizjes kundër regjimit. Atyre që na ndajnë në idealistë (të VETËVENDOSJE!-s) dhe të gjithë të tjerët (përfshirë edhe popullin këtu) në materialistë, duhet t'ua përkujtojmë se edhe shumica e materialistëve nuk po përfitojnë por vetëm një pakicë e tyre. Në revolucion ka shumë tradhtarë. Aso që e braktisin lojalitetin e vjetër dhe i bashkohen Lëvizjes së re. Pa shumësi tradhtarësh (të regjimit), s'ka revolucion (të popullit).

Lëvizja s'është parti

Përderisa Kosova është më pak se shtet, meqë nuk është tamam shtet, VETËVENDOSJE! gjithsesi duhet të jetë më shumë sesa parti politike. Kur shteti nuk ka sovranitet, demokraci, drejtësi dhe zhvillim ekonomik, pra siç është rasti me Kosovën, atëherë partitë s'janë parti. Ato ose janë fraksione të regjimit sundues ose janë (a bëhen) lëvizje. Pra, jo vetëm që partia në atë situatë nuk është zgjidhje, por ajo është e pamundur (të jetë).

Jo pak bëhet trysni në Lëvizjen që të shndërrohet në parti politike. Aktualisht Lëvizja jonë është njëlloj mundësie e mundësisë për revolucion. Kjo u pengon jashtëzakonisht shumë njerëzve të regjimit meqë kësisoj e mbajmë lart flamurin e shtegut të lirisë dhe drejtësisë që buron nga populli dhe realizohet nga ai vetë. Lëvizja e bën përfaqësimin prani. Partinë e absorbon shteti. Lëvizjen nuk mundet.

Partitë tjera kanë fraksione sepse vetë janë fraksione dhe duan monopol. Në Lëvizje nuk ka as fraksione e as monopol. Partitë tjera nuk janë as parti. Ndërsa VETËVENDOSJE! është më shumë se parti, është Lëvizje. Partitë e ndajnë materien në pjesë. Lëvizja e shndërron materien në energji. Partia e ka më të madh aktualitetin sesa potencialitetin. Lëvizja e ka më të madh potencialitetin sesa aktualitetin.

Lëvizja VETËVENDOSJE! nuk e ka për pushtet sepse ka Alternativë Qeverisëse. Subjektet e tjera i shohin njerëzit në Kosovë si votues partish kurse VETËVENDOSJE! i sheh ata si qytetarë të Republikës. Ne nuk vijmë në pushtet. Populli vjen në pushtet. Kur fiton Lëvizja, fiton populli. Çka të thotë populli do të bëhet, jo çka të thonë politikanët. Me pushtetin e VETËVENDOSJE!-s nëpër komuna duhet të fuqizohet Bashkësia Lokale si aspekt i decentralizimit mbi baza qytetare.

Lëvizja dallon në shumë rrafshë nga partia politike. Lëvizja është organizëm dinamik që e merr emrin e veprimt, pra ekziston si organizatë për shkak të forcës goditëse që dëshiron ta japë. Ndërkaq, partia është strukturë më pasive që identifikohet me rendin e saj hierarkik. Në Lëvizjen VETËVENDOSJE! nuk ka degë të Lëvizjes por ka Qendra të Lëvizjes, pra një organizim më horizontal se tek partitë politike. Qendrat e VETËVENDOSJE!-s përbëhen nga pikat e VETËVENDOSJE!-s të cilat organizohen në nivel të fshatit ose të lagjes së qytetit.

Lëvizja karakterizohet nga mospërshtatja. Në Kosovë, por mbase jo vetëm në Kosovë, përshtatja definohet si urtësi – në gjuhën shqipe thuhet për dikë i urtë në dy kuptimet e kësaj fjale: i urtë, domethënë që është i qetë dhe nuk ia trazon ujin askujt, por i urtë edhe në kuptimin e mençurisë e të dijës, në kuptimin e një thellësie e pjekurie. Pra, ata të cilët janë të qetë, ata të cilët përshtaten, janë të urtë. E Lëvizja nuk është e urtë. Nuk është e urtë në kuptimin e parë të fjalës sepse është e urtë në kuptimin e dytë të fjalës. Pikërisht duke qenë të mençur ne nuk jemi të qetë. Lëvizja është lum pa brigje. Nuk është liqe sepse s'ka brigje dhe nuk është vërshim sepse është lum.

Lëvizja do t'i konsistonte prodhimit. Partia i konsiston shitblerjes. Partitë janë bërë të pashpresa sepse duan rezultate të shpejta dhe nuk besojnë në rezultate të shpejta. Qasja e tyre është tregtare e financiare dhe jo prodhuese. Pikërisht kur ke prodhim atëherë ke edhe planifikim. Vetëm ata që prodhojnë, planifikojnë. Vetëm ata që prodhojnë kanë vizion, sepse ata mbjellin dhe në fund korrin. Mu ata që prodhojnë nuk presin rezultate të shpejta – këtë karakter e ka Lëvizja politike. Ata që blejnë dhe shesin, ata që merren me tregti, duke synuar të blejnë sa më lirë e të shesin sa më shtrenjtë, ata kanë logjikë të atypër-atyshme dhe afatshkurtër. Ndërkaq, ata që prodhojnë, ata bëjnë planifikim dhe ata kanë vizion, synime e plane. Pra, përderisa partitë politike më shumë janë të orientuara kah tregtia, një lëvizje politike gjithsesi është më shumë e orientuar te prodhimi. Përderisa partia politike është më shumë te korrja, lëvizja politike është më shumë tek

mbjellja. Përderisa partia politike është më shumë te dëshira dhe ankesat, lëvizja politike është më shumë te vullneti dhe kritika. Përderisa partia politike konstituohet kundrejt qeverisë, ose në qeveri, lëvizja politike konstituohet kundrejt sistemit duke qenë edhe jashtë tij.

Inkuadrimi i Lëvizjes VETËVENDOSJE! në institucionet e sistemit është zgjerim i mjeteve të përdorimit kolektiv politik (e jo i mjeteve të konsumit individual materialist, siç është rasti me politikanët e partive). Lëvizja i kombinon mjetet institucionale me mjetet jashtinstitucionale. VETËVENDOSJE! ka një përfytyrim tjetër prej partisë politike sa i përket institucioneve të sistemit. Ne nuk i mendojmë institucionet e sistemit si një shtëpi me salltanet ku do të banojmë, por si mjete të reja të cilat do t'i përdorim. Pra, kemi një imagjinare kolektive brenda nesh e cila është shumë dinamike dhe e cila thotë që duhet të politizohet demokracia. Duhet të kesh një projekt politik dhe ta bësh betejën demokratike. Por, beteja demokratike pa projekt politik, e degradon partinë politike në klan i cili vendoset në shtëpinë e re dhe luksoze që quhet Kuvend, Qeveri, apo ndonjë institucion tjetër. Lëvizje do të thotë të ecësh (që të arrish). Parti do të thotë të shfaqesh (që të mbetesh). “Përfaqësimi është regjimi i rezultatit.” (“Representation is the regime of the result.”) – Alain Badiou

Në parlament ndahesh prej qytetarëve dhe bashkohesh me kundërshtarët. I ke shumë afër kundërshtarët e tu dhe je shumë larg qytetarëve – kjo është arsyeja pse Lëvizja VETËVENDOSJE! është ndryshe prej subjekteve tjera: Kuvendin e Kosovës e sheh si fushëbetejë, e sheh si arenë në të cilën ballafaqohemi me kundërshtarët. Ka pafund mekanizma të imët të institucioneve të sistemit të cilat dëshirojnë që përfaqësuesin e popullit ta ndajnë nga populli. Ato duhet t'i evidentojmë një nga një dhe po ashtu t'i gjejmë hendeqet midis përfaqësuesve dhe të përfaqësuarve në mënyrë që t'i eliminojmë ato.

PDK-ja është kleptokraci – sa më lartë që ngjitesh, aq më të mëdhenj (dhe më të pasur) janë vjedhësit aty. Ata sundojnë njëri-tjetrin aty brenda dhe që të gjithë bashkë mandej sundojnë me popullsinë. Sundimi me popullsinë ua mundëson sundimin me njëri-tjetrin. Dhe kur zgjedhet në një post politikani i tyre, ai më parë mendon se si është i veçantë meqë është zgjedhur sesa për përgjegjësinë për interesin e përgjithshëm.

PDK dhe LDK janë në një kundërthënie të rrejshme e cila synim ka përjashtimin e Lëvizjes sonë me të cilën kjo kundërthënie e rrejshme ndodhet në antagonizëm të vërtetë. LDK-ja ishte opozitë jo në masën që ajo mund të ishte opozitë, por në temën e kohën që PDK-ja e donte si opozitë. PDK-ja u bashkua me LDK-në që të vazhdojë kurse LDK-ja u bashkua me PDK-në që të shpëtojë. Humbjet e dështimet e VETËVENDOSJE!-s porsì fitoret dhe sukseset e PDK-së e LDK-së janë fort të përkohshme.

Fytyrat e ndryshme të politikanëve në Kosovë e maskojnë faktin që bëhet fjalë për të njëjtin politikan. Subjektet tjera prodhojnë ngjarje ceremoniale, përrurime me prerje shiritash. Ato janë te fragmentizmi. Ne duhet të jemi te përfytyrimi i botës së re, i Kosovës së re, i Republikës së Tretë, i bashkimit kombëtar, i drejtësisë universale, i barazisë së përgjithshme, i tërësisë. Republika e parë u shpall para se shpërbëhej Jugosllavia (me luftë), më 2 korrik 1990. E dyta, para se të shpërbëhej Kosova (me

decentralizim), më 17 shkurt 2008. E treta republikë na duhet për zhvillim dhe bashkim, sa më parë.

Janë tri rreziqe që i kanosen një lëvizjeje sipas filozofit francez, Alain Badiou. Rreziku i parë është lodhja. Jo pak njerëz hyjnë në lëvizje politike duke menduar se aktiviteti politik do të zgjas 6 muaj, një vit apo 2 vite dhe mandej do të ketë sukses, e kur kjo nuk ndodhë, atëherë dëshpërohen, braktisin subjektin politik dhe heqin dorë prej ndryshimeve dhe nisin të përshtaten. Logjika e tregtisë të lodhë shumë më shpejt; logjika e prodhimit të bënë shumë më të qëndrueshëm. Angazhimi politik në Lëvizje nuk është, le ta themi me gjuhën e atletikës, vrapim sprinti në 100 metra, por është shumë më shumë e më gjatë se kaq. Madje, mund të jetë edhe maratonë; dhe, sa më shumë që do të jemi të gatshëm për angazhimin politik si maratonë, aq më i shkurtër se maratona do të bëhet ky angazhim i nevojshëm politik deri në fitore. Rreziku i dytë është dogmatizmi. Pra, një lëvizje rrezikon të bëjë një interpretim tejet ortodoks të diskursit të saj, të bëhet ekskluzive dhe kështu të përfundojë e kufizuar në një bërthamë militantësh që pajtohen vazhdimisht me njëri-tjetrin, por nuk arrijnë që të zgjerohen në popull. Ndërkaq, rreziku i tretë është devijimi. Pra, ndryshimi i konceptit, i idesë, i programit, për t'u përshtatur për një fitore sa më të shpejtë, sa më të kollajshme e për t'u bërë sa më i pranueshëm. Ashtu braktisen orientimi dhe vlerat për poste me ç' rast mbase edhe fiton por nuk je më ai që është dashur të fitojë. Në të tri rastet ne duhet të jemi vazhdimisht të kujdesshëm: të mos lodhemi, të mos bëhemi dogmatikë dhe të mos devijojmë.